



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.153

23 nëntor

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MPPT nr. 3606/2, datë 28.10.2011	Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, CE, d (*) dhe DE, me Certifikatën e Aftësimi Profesional (CAP).....	7025
Vendim i GJK nr.46, datë 4.11.2011	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr.950, datë 30.10.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.974, datë 10.11.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.....	7041
Vendim i GJK nr.47, datë 7.11.2011	Me objekt shfuqizimin, si antikushtetues, të vendimeve: nr.44, datë 1.7.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr.40, datë 7.7.2009 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe nr.00-2010-933 (731), datë 2.7.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	7044
Vendim i GJK nr.48, datë 8.11.2011	Me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushtetit qendror (Kuvendi i Shqipërisë) dhe pushtetit vendor (Bashkia e Tiranës); Shfuqizimi i vendimit nr.66, datë 21.10.2010 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ndërtimin e Kompleksit të Ri Parlamentar” si i papajtueshëm me Kushtetutën; Pezullimi i zbatimit të vendimit nr.66, datë 21.10.2010 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ndërtimin e Kompleksit të Ri Parlamentar”	7054

UDHËZIM
Nr. 3606/2, datë 28.10.2011

**PËR PAJISJEN E PËRDORUESVE TË MJETEVE RRUGORE TË KATEGORIVE C, CE, D
(*) DHE DE, ME CERTIFIKATËN E AFTËSIMIT PROFESIONAL (CAP)**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, pikës 8 dhe 9 të nenit 115, të nenit 224 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 294, 295, 296 dhe 297 të vendimit nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i këtij udhëzimi është përgatitja e drejtuesve të mjeteve që për efekt të veprimtarive ekonomike në transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave, brenda dhe jashtë vendit, do të jenë përdorues të mjeteve rrugore motorike dhe të kombinuara, drejtimi i të cilave kërkon aftësimin profesional i cili vërtetohet me pajisjen e tyre me “Certifikatën e aftësimin profesional”. Pajisja me këtë certifikatë, gjithashtu, do të synojë përmirësimin e sigurisë si në drejtim të operacioneve që kryhen nga ata gjatë përpunimit të ngarkesave që do të transportojnë ashtu edhe gjatë lëvizjes në rrugë për efekt të këtij transporti.

Neni 2

Certifikata e aftësimin profesional, e cila për efekt të përdorimit të shpeshtë në këtë udhëzim do të shënohet CAP, lëshohet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR-ja) dhe është një dokument që vërteton aftësimin profesional të përdoruesve të mjeteve rrugore që drejtohen me leje drejtimi të kategorive C, CE, D(*) dhe DE, modeli i të cilës, pjesë e këtij udhëzimi, është i njëjtë me ato që parashikon direktiva e BE-së 2003/59/KE.

Neni 3

CAP është dokument personal, pjesë e dokumentacionit të qarkullimit të mjetit, e vlefshme vetëm për përdorimin e mjeteve të përcaktuara në kategoritë e shënuara të cilat në të gjitha rastet duhet të jenë në përputhje me kategoritë e lejes së drejtimit të mbajtësit të saj.*

Neni 4

CAP lëshohet në varësi të kërkesës dhe lejes së drejtimit të kandidatit dhe për këtë arsye ajo përbëhet nga këto tipa:

a) Tipi KC, për drejtuesit e automjeteve teke me peshë maksimale të autorizuar mbi 3.5 ton, të pajisur me leje drejtimi të kategorisë C;

* Bëjnë përjashtim mbajtësit e lejes së drejtimit të kategorisë D kur janë duke kryer shërbimin taksi.



b) Tipi KC+E, për drejtuesit e automjeteve të artikuluar dhe gjysmërimorkiatorëve, dhe tërheqjen e rimorkiove, nëse përdoruesi i tyre është i pajisur me leje drejtimi të kategorisë CE;

c) Tipi KD, për drejtuesit e autobusëve dhe automjeteve të tjera të destinuara për transportin e pasagjerëve, që kanë më shumë se 8 ndenjëse, të pajisur me leje drejtimi të kategorisë D;

d) Tipi KD+E për drejtuesit e automjeteve të artikuluar, gjysmërimorkiove për transportin e udhëtarëve, të pajisur me leje drejtimi të kategorisë DE.

Neni 5

Përfshihen nga detyrimi për pajisjen me CAP, drejtuesit e automjeteve:

a) shpejtësia maksimale e autorizuar e të cilave nuk i kalon 45 km/orë;

b) të përdorura nga, ose nën kontrollin e Forcave të Armatosura, mbrojtjes civile, shërbimeve kundër zjarrit dhe forcave përgjegjëse për ruajtjen e rendit publik;

c) që kalojnë testet rrugore për qëllime të zhvillimit teknik, riparimit ose mirëmbajtjes, ose të mjeteve të reja apo të rindërtuara të cilat akoma nuk janë futur në shërbim;

d) të përdorura në rastet e emergjencës ose të caktuara për misionet e shpëtimit;

e) të përdorura në kursin e mësimin të drejtimit të mjetit për çdo person që ka dëshirë të marrë një leje drejtimi ose një CAP;

f) të përdorura për transportin jotregtar të pasagjerëve ose mallrave, për përdorim personal;

g) që mbartin materiale ose pajisje për t'u përdorur nga drejtuesi i mjetit gjatë punës së tij apo saj, duke siguruar që drejtimi i mjetit nuk është aktiviteti kryesor i drejtuesit të mjetit.

Neni 6

Përgatitja e kandidatëve që do të kërkojnë të pajisen me CAP, për kategoritë respektive KC dhe KD do të realizohet nëpërmjet kurseve të kualifikimit dhe trajnimeve periodike, të detyrueshme, mbi bazën e programeve mësimore të miratuara nga Ministri.

Drejtuesit e mjeteve, të cilët kanë leje drejtimi të kategorive C dhe CE, D[†] dhe DE ose leje drejtimi të njohura si të barazvlershme, para datës së hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të pajisen me CAP pa iu nënshtruar kualifikimit dhe pa testim, mbi bazën e modaliteteve të përcaktuara nga DPSHTRR-ja. Pas përfundimit të vlefshmërisë së lejeve, këto kategori do t'i nënshtrohen kualifikimit, trajnimit periodik dhe testeve përkatëse.

KREU II KUALIFIKIMI DHE TRAJNIMI

Neni 7

Kualifikimi dhe trajnimi periodik i kandidatëve që do të kërkojnë të pajisen me CAP, si përdorues të mjeteve rrugore motorike dhe të kombinuara, drejtimi i të cilave kërkon aftësimin e detyrueshëm profesional, bëhet vetëm në autoskollë që janë autorizuar nga DPSHTRR-ja.

Neni 8

DPSHTRR-ja për përgatitjen e kandidatëve që do të kërkojnë të pajisen me CAP, si përdorues të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, drejtimi i të cilave kërkon aftësim të

[†] Bëjnë përjashtim mbajtësit e lejes së drejtimit të kategorisë D kur janë duke kryer shërbimin taksit.

detyrueshëm profesional, autorizon vetëm autoshkollat që në përputhje me kërkesat e direktivës BE 2003/59/CE, datë 15.7.2003, kanë përgatitur të gjithë bazën e nevojshme mësimore sipas nenit 9 të këtij udhëzimi.

Neni 9

Për t'u autorizuar nga DPSHTRR-ja për përgatitjen e kandidatëve që do të kërkojnë të pajisen me CAP si përdorues të mjeteve rrugore motorike dhe të kombinuara, drejtimi i të cilave kërkon aftësim të detyrueshëm profesional, autoshkolla duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) të ketë “Licencën autoshkollë” për përgatitjen e kandidatëve për pajisjen me leje drejtimi për të gjitha kategoritë (A, B, C, CE, D dhe DE)

b) të ketë ushtruar pa ndërprerje aktivitetin “Autoshkollë” të paktën 3 vjet dhe ta vërtetojë këtë gjë nga drejtoria rajonale e shërbimit të transportit rrugor, drejtoria e taksave dhe tatimeve dhe sigurimet shoqërore;

c) të ketë të veçantë për këtë aktivitet, një rregullore të brendshme, ku të jenë përcaktuar oraret e veprimtarisë, mënyra e përcaktimit të seancave teorike dhe atyre praktike, detyrat e instruktorëve dhe të kandidatëve, zbërthimi analitik i programit, bashkëlidhur këtij udhëzimi, administrimi i dokumentacionit të autoshkollës, kushtet e marrëveshjes me kandidatët dhe përcaktimi i tarifave të shërbimit;

d) të ketë të punësuar, me kontratë të rregullt noteriale, një drejtues teknik të veçantë, të pajisur me “Dëshminë e aftësisë profesionale” (DAP) për përgatitjen teorike të këtyre kandidatëve;

e) të ketë të punësuar, me kontratë të rregullt noteriale, të paktën një instruktor për mësimin praktik, i pajisur me leje drejtimi dhe CAP, të njëjtë me atë që autoshkolla kërkon lejen e veprimtarisë.

f) të ketë për ambient mësimdhënies, një klasë me të paktën 25 m², ku një kandidat të ketë të disponueshme të paktën 1,50 m² të pajisur me arredimin e përshtatshëm dhe të jetë i ndarë nga zyrat e tjera ose ambientet e tjera publike. Gjithashtu të ketë pajisje didaktike për përdorimin e tahogرافit;

g) të disponojë mjete për kategoritë respektive të lejeve të drejtimit për tu pajisur me CAP sipas kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000, të ndryshuar dhe udhëzimit nr.994, datë 12.3.2003, i ndryshuar si dhe direktivës 2006/126/EC, si më poshtë:

- Për certifikatën e tipit KC: një mjet të kategorisë C me masë maksimale të autorizuar prej të paktën 12 000 kg, me një gjatësi prej të paktën 8 m, gjerësi të paktën 2,4 m dhe me shpejtësi të paktën 80 km/orë; pajisur me frena kundër bllokimit (ABS), si dhe me kuti shpejtësie që ka të paktën tetë marshe përpara dhe tahogراف sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullores për organizimin e kohës së punës së personave që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1054, datë 22.12.2010 “ Mbi pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor”; pjesa e ngarkesës duhet të jetë një trup i mbyllur kuti i cili të paktën është i gjerë sa lartësia e kabinës. Mjeti në procesin e përgatitjes dhe të provave duhet të jetë me një masë të përgjithshme minimale reale prej 10 000 kg.

- Për certifikatën e tipit KC+E; një mjet i artikuluar ose një kombinim i mjetit të kategorisë C me një rimorkio të paktën 7,5 m të gjatë. Si mjeti i artikuluar dhe kombinimi do të kenë një masë maksimale të autorizuar të paktën 20 000 kg, një gjatësi prej të paktën 14 m dhe një gjerësi prej të paktën 2,40 m dhe të kenë shpejtësi prej të paktën 80 km/h, pajisur me frena kundër bllokimit, si dhe me kuti shpejtësie me të paktën 8 marshe përpara, si dhe me pajisje të regjistrimit të shpejtësisë dhe kohës (tahogراف). Pjesa e ngarkesës do të përbëhet nga një trup kuti e mbyllur, i cili është i gjerë dhe i lartë sa kabina dhe si mjeti i artikuluar dhe kombinimi gjatë përgatitjes dhe provave do të jenë me një peshë reale minimale prej 15 000 kg.



- Për certifikatën e tipit KD: një mjet i kategorisë D me gjatësi të paktën 10 m, gjerësi të paktën 2,40 m dhe shpejtësi të paktën 80 km/h; i pajisur me frena kundër bllokimit, si dhe me pajisje të regjistrimit të shpejtësisë dhe kohës (tahograf).

- Për certifikatën e tipit KD+E: një kombinim i përbërë nga një mjet i kategorisë D dhe një rimorkio me një masë maksimale të autorizuar prej të paktën 1250 kg, një gjerësi së paku 2,40 m dhe me një shpejtësi të paktën prej 80 km/h; Pjesa e ngarkesës së rimorkios të jetë një trup kutie i mbyllur i cili është të paktën 2 m i gjerë dhe 2 m i lartë; rimorkio do të jetë me një masë të përgjithshme minimale reale prej 800 kg.

Neni 10

Programet mësimore që do të aplikohen gjatë kualifikimeve dhe trajnimeve periodike, pjesë e këtij udhëzimi shtojca I, përpilohen nga DPSHTRR-ja në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1054, datë 22.12.2010 “Mbi pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor”, manualeve teknike të përdorimit të mjeteve respektive, dhe në përputhje me kërkesat e direktivës së BE-së 2003/59/EC.

Neni 11

Kualifikimi dhe trajnimi periodik, në përmbushje të detyrimeve të direktivës 2003/59/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian, datë 15.7.2003, do të realizohet nëpërmjet një programi mësimor, që do të aplikohet në kurset e trajnimit përkatës dhe që përbëhet nga 60 orë mësimi teorik, të cilat do të kryhen në jo më pak se 15 ditë dhe 10 orë të praktikës mësimore, të cilat do të zhvillohen në jo më pak se 5 ditë.

Neni 12

Programet mësimore që do të aplikohen gjatë kualifikimeve dhe trajnimeve periodike, përveç rifreskimit të njohurive të fituara në kualifikimet e mëparshme do të përmbajnë edhe pasqyrojnë të gjitha zhvillimet e reja në legjislacionin rrugor të vendit dhe ndërkombëtar, si dhe të rejat në fushën e teknologjisë së prodhimit dhe ndërtimit të mjeteve rrugore.

Programi teorik dhe praktik realizohen të alternuar për të mundësuar interpretimet reciproke të tyre.

Neni 13

Të gjithë kandidatët që kanë vijuar rregullisht kurset e kualifikimit do t’i nënshtrohen një testimi teorik dhe praktik pranë drejtorisë rajonale, ndërsa kandidatët që kanë vijuar rregullisht kurset e trajnimit periodik i nënshtrohen vetëm testimit teorik. Pas përfundimit me sukses të testimit, kualifikimi do të certifikohet me lëshimin e CAP, sipas nenit 2 dhe 4 të këtij udhëzimi.

KREU III REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Neni 14

Për t’u regjistruar në kursin e pajisjes me CAP, kandidatët që do të kërkojnë të përdorin një mjet që mund të drejtohet me leje drejtimi të kategorive C, CE, D dhe DE, duhet të kenë mbushur respektivisht moshën:

- a) 20 vjeç për kategorinë C për CAP të kategorisë KC;
- b) 21 vjeç për kategorinë CE për CAP të kategorisë KC+E;
- c) 23 vjeç për kategorinë D për CAP të kategorisë KD;
- d) 24 vjeç për kategorinë DE për CAP të kategorisë KD+E.

Neni 15

Regjistrimi i kandidatit që do të kërkojë të ndjekë kursin e kualifikimit bëhet në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), e cila ka në juridiksion vendbanimin e tij.

Për t'u regjistruar kandidati nëpërmjet autoshköllës duhet të paraqesë në zyrën e pranimit të DRSHTRR-së, një kërkesë me shkrim sipas formularit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja, si dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) fotokopje të kartës së identitetit;
- b) vërtetim banimi;
- c) fotokopje e lejes së drejtimit;
- d) fotokopjen e CAP, përfituar më parë;
- e) fotokopje të dëftesës së përfundimit të arsimit të detyruar;
- f) certifikatën mjekësore;
- g) dy copë fotografi format 4x6.

Procedurat e regjistrimit, provimit, riprovimit, lëshimit të certifikatave të aftësisimit profesional dhe rinovimi i tyre përcaktohen nga DPSHTRR-ja.

Neni 16

Nëse në rrethet që janë në juridiksionin e DRSHTRR-së që mbulon vendbanimin e një kandidati nuk ka asnjë autoshköllë të autorizuar për këtë veprimtari, ai mund të drejtohet në një autoshköllë që kryen këtë veprimtari jashtë juridiksionit të saj, pasi të jetë pajisur nga drejtoria rajonale ku ka vendbanimin me vërtetimin përkatës se në juridiksionin e saj nuk ka autoshköllë të autorizuar për CAP.

Neni 17

DRSHTRR-ja, pasi verifikon rregullshmërinë e dokumentacionit të paraqitur nga autoshkölla, për kandidatin lëshon autorizimin për vijimin e kursit, i cili së bashku me të përbëjnë dosjen e tij, e cila më pas i dërgohet përsëri autoshköllës.

Vlefshmëria për përgatitjen teorike dhe praktike të kandidatit (autorizimi) që kërkon të pajiset me një nga tipat e CAP të parashikuar është një vit nga data e lëshimit.

KREU IV TESTIMI I KANDIDATËVE

Neni 18

Në përfundim të programit mësimor teorik dhe praktik, autoshköllat paraqesin të paktën 1 (një) ditë përpara pranë zyrës përkatëse të DRSHTRR-së, dorazi ose me postë, listën emërore dhe dosjet e plota të kandidatëve që kanë vijuar rregullisht kursin e trajnimit periodik dhe që janë të aftë t'i nënshtrohen testimit të njohurive të fituara. Dosjet dorëzohen pranë komisionit të testimit në momentin e paraqitjes së kandidatit për testim. Çdo kandidat do t'i nënshtrohet dy testeve të veçanta, testit teorik dhe testit praktik.



Çdo kandidat ka në dispozicion 5 (pesë) mundësi teorike dhe 5 (pesë) mundësi praktike brenda vlefshmërisë së autorizimit, për t'u shpallur fitues i CAP të kërkuar prej tij. Nëse janë konsumuar të gjitha mundësitë e kalimit të testeve apo të afatit të vlefshmërisë së autorizimit kandidati duhet të kërkojë një regjistrim të ri.

Neni 19

Testi teorik do të përbëhet nga dy pjesë:

- a) pyetje, që nga ndërtimi do të kërkojnë zgjidhje konkrete të situatave apo procedurave që lidhen me transportin rrugor të mallrave apo udhëtarëve;
- b) pyetje që kërkojnë përgjigje të drejtpërdrejtë (po ose jo).

Testi teorik do të përbëhet nga 60 pyetje, 85% ose 51 prej të cilave, aplikanti duhet t'i japë përgjigje korrekte për t'u shpallur fitues. Koha në dispozicion të aplikantëve për plotësimin e përgjigjeve të një testi teorik do të jetë deri në 4 orë.

Neni 20

Testi praktik do të përbëhet nga dy pjesë:

a) testi i vlerësimit praktik të situatave apo ngjarjeve aktuale që lidhen me zbatimin rigoroz të rregullave të sigurisë në lëvizje dhe qarkullimit në rrugë, të cilat paraqesin të gjitha llojet e niveleve të vështirësive apo situatave kritike me të cilat kandidati duhet ballafaquar. Kohëzgjatja e këtij testi duhet të jetë 45 minuta.

b) testi praktik që lidhet me aftësinë e drejtuesit kandidat në lidhje me: ngarkimin e automjetit me kujdesin e duhur, sigurimin e vendosjes së pasagjerëve në përshtatje me komoditetin e kërkuar në udhëtim, parandalimin e kriminalitetit dhe trafikun e emigrantëve të paligjshëm, parandalimin e rreziqeve të mundshme, rëndësinë e aftësisë mendore dhe fizike në qarkullim, vlerësimin e situatave të urgjencës etj. Kohëzgjatja minimale e këtij testi duhet të jetë 30 minuta.

Neni 21

Testimi teorik dhe praktik i kandidatëve që kërkojnë të pajisen me CAP, organizohet nga DPSHTRR-ja, nëpërmjet strukturave përkatëse të cilat për çdo rast duhet të bëjnë përgatitjen paraprake të testeve duke i vënë në dispozicion të komisioneve të miratuara.

Neni 22

Testimi i kandidatëve organizohet dhe zhvillohet pranë DRSHTRR-ve, sipas kërkesave të subjekteve autoshkolla. Datat e zhvillimit të testimit propozohen nga DRSHTRR-ja dhe miratohen nga DPSHTRR-ja.

Neni 23

Testimi teorik dhe praktik i kandidatëve bëhet nga një komision i përbërë nga 2(dy) inxhinierë mekanikë të pajisur me të gjitha kategoritë e lejeve të drejtimit dhe certifikatën për ushtrimin e detyrës së anëtarit të komisionit të marrjes në prova. Komisioni i testimit administron të gjithë dokumentacionin e kandidatëve, si dhe plotëson regjistrin e protokollit dhe autorizimin e kandidatit sipas modeleve të përcaktuara nga DPSHTRR-ja. Kandidatët e shpallur fitues të testit teorik, merren edhe në provimin praktik, i cili zhvillohet jo më vonë se 10 ditë nga testi teorik.

Kandidatët shpallen fitues vetëm nëse vlerësohen pozitivisht në të dy testet.

Komisioni i testimit mund të jetë pjesë e strukturave të DRSHTRR-së ose i caktuar me urdhër të veçantë nga Drejtori i Përgjithshëm rast pas rasti në vartësi të fluksit të kërkesave.

Neni 24

DRSHTRR-ja i lëshon kandidatit fitues certifikatën e aftësisimit profesional të drejtuesit të mjetit, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i fitimit të provave nga ana e tij.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25

DRSHTRR-ja, për të gjithë kandidatët e shpallur fitues të testeve respektive, plotëson certifikatën e aftësisimit profesional duke bërë shënimet përkatëse në të gjitha rubrikat e saj. Në të gjitha rastet CAP firmoset nga drejtori i drejtorisë rajonale.

Neni 26

ÇAP-et e plotësuara u dorëzohen autoshkollave përkatëse të cilat bëjnë shpërndarjen e tyre, ndërsa dosjet e kandidatëve të shpallur fitues arkivohen.

Neni 27

Afati i vlefshmërisë së CAP është 5 vjet nga data e lëshimit, por në të gjitha rastet brenda vlefshmërisë së kategorisë respektive të lejes së drejtimit të mbajtësit të saj.

Neni 28

Rinovimi i CAP bëhet vetëm pas skadimit të afatit të saj të vlefshmërisë dhe vetëm nëse mbajtësi i saj i është nënshtruar trajnimit periodik dhe është shpallur fitues në testin teorik. DPSHTRR përgatit programet mësimore teorike mbi temat e rishikuara dhe të zgjeruara të shtojcës I të udhëzimit, duke i vënë theks të veçantë sigurisë në rrugë. Kohëzgjatja e trajnimeve periodike duhet të jetë 35 orë.

Zotëruesit e CAP dhe drejtuesit e mjeteve të përmendur në nenin 6, të cilët kanë ndërprerë aktivitetin profesional do të ndjekin trajnimin periodik përpara rifillimit të aktivitetit.

Drejtuesit e mjeteve të cilët kanë përfunduar trajnimin periodik për një nga kategoritë e lejeve të drejtimit të parashikuar në nenin 4 do të përjashtohen nga detyrimi i ndjekjes së trajnimit të herëpashershëm të mëtejshëm për kategoritë e tjera të parashikuara në këto paragrafë.

Neni 29

Në rast humbjeje, vjedhjeje, dëmtimi apo shkatërrimi të CAP-it, mbajtësi i saj duhet që brenda 48 orëve të bëjë një denoncim në komisariatit e policisë që mbulon vendbanimin e tij dhe pas kësaj i jepet e drejta për të kërkuar pajisjen me një CAP të ri i cili i lëshohet atij jo më pak se 15 ditë mbas denoncimit. Në këto raste afati i vlefshmërisë së CAP do mbetet i njëjtë me atë të CAP të mëparshëm.

Neni 30

Tarifat e shërbimit për regjistrimin, testimin, ritestimin dhe pajisjen e aplikantëve me CAP do të jenë të njëjta me ato që janë miratuar nga Ministria për praktikën e regjistrimit, testimin, ritestimit dhe pajisjes së aplikantëve që kërkojnë të pajisen me leje drejtimi C, D dhe CE, DE.



Neni 31

Modelet e CAP që lëshohen nga DPSHTRR-ja janë bashkëlidhur.

Në rast të lëshimit të kartës CAP karakteristikat fizike duhet të jenë në përputhje me standardet ISO 7810 dhe 7816-1. Metodat për verifikimin e karakteristikave fizike të kartës për t'u siguruar që ato janë në përputhje me standardet ndërkombëtare duhet të jenë në përputhje me standardin ISO 10373.

Ngjyrat e referencës:

-Blu: refleksi panton blu

-E verdhë: panton e verdhë.

Niveli i sigurisë së kartës duhet të jetë të paktën i krahasueshëm me nivelin e sigurisë së lejes së drejtimit.

Neni 32

DPSHTRR-ja të marrë masat e duhura për zbatimin e këtij udhëzimi brenda 45 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 33

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi**

SHTOJCA I

PROGRAMI TEORIK DHE PRAKTIK PËR TRAJNIMIN PERIODIK TË KANDIDATËVE QË ZOTËROJNË KATEGORITË E LEJEVE TË DREJTIMIT C, CE, D DHE DE DHE QË DO TË KËRKOJNË TË PAJISEN ME CERIFIKATËN E AFTËSISË PROFESIONALE RESPEKTIVE SI PËRDORUES TË MJETEVE RRUGORE

Qëllimi i programit

Përgatitja teorike dhe praktike për efekt kualifikimi dhe pajisje me Certifikatë të Aftësisë Profesionale (CAP) të kandidatëve, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, manualeve teknike të përdorimit të mjeteve respektive dhe në përputhje me kërkesat e direktivës së BE 2003/59/EC.

Përmbajtja e programit

I. Programi teorik

Programi teorik që do të aplikohet nga autoshkollat për përgatitjen e kandidatëve që do të kërkojnë të pajisen me Certifikatën e Aftësisë Profesionale do të zhvillohet në 60 orë mësimi respektivisht sipas temave të mëposhtme:

Tema nr.1: Udhëzimi i Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit “Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, CE, D dhe DE, me Certifikatën e Aftësisë Profesionale” Gjithsej 4 orë

a) Direktivat e Komunitetit Europian për detyrimin e pajisjes së përdoruesve të mjeteve rrugore me Certifikatën e Aftësisë Profesionale për disa transporte specifike mallrash dhe udhëtarësh orë 2 (dy)

b) Mjetet, drejtimi i të cilave kërkon pajisjen e përdoruesve me CAP, detyrimet,

përrjashtimet, vlefshmëria dhe rinovimi i CAP	orë 2 (dy)
Tema nr.2: “Njohuri të veçanta nga ligji nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar	Gjithsej 8 orë
a) Mjetet rrugore dhe klasifikimi i tyre, automjetet dhe rimorkiot, karakteristikat konstruktive dhe funksionale të mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre dhe sistemet e pajimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre (neni 46,47, 54, 56, 71 dhe 72)	orë 4 (katër)
b) Të dhëna për identifikimin e mjetit dhe gjendjen teknike të tij (neni 74, 78 dhe 79)	orë 1 (një)
c) Transporti i mallrave dhe i njerëzve me mjetet me motor dhe me rimorkio (neni 165 dhe 167), masat administrative përkatëse.	orë 1 (një)
d) Drejtimi i mjeteve, normat e sjelljes, qarkullimi në rrugët urbane, interurbane dhe autostrada.	orë 2 (dy)
Tema nr.3: “Njohuri të veçanta nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 “Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor”, i ndryshuar.	Gjithsej 5 orë
a) Klasifikimi i mjeteve rrugore për efekt dallimi dhe raportimi në funksion të numrit të akseve dhe të peshës bruto (neni 195).	orë 1 (një)
b) Automjete dhe rimorkiot për transport dhe për përdorim të veçantë (neni 201, 202)	orë 1 (një)
c) Formalitetet për qarkullimin e mjeteve rrugore (neni 237, 243, 344, neni 252) dhe mjetet jashtë norme dhe mjetet që përdoren për transporte në kushte jo normale (neni 8, 9, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18).	orë 3 (tre)
Tema nr.4: “Njohuri të veçanta nga ligji nr.8308, datë 18.9.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.	Gjithsej 5 orë
a) Objekti, qëllimi zbatimi dhe terminologjia (neni 1-8).	orë 1 (një)
b) Transporti i udhëtarëve, brenda dhe jashtë vendit. Llojet e transporteve dhe mjetet përkatëse (neni 9-38).	orë 2 (dy)
c) Transporti i mallrave, brenda dhe jashtë vendit. Llojet e transporteve dhe mjetet përkatëse (neni 39-63).	orë 2 (dy)
Tema nr.5: Kontrolli i kohës së punës të drejtuesit të mjetit, koha e pushimit. Tahografi	
(vendim i Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullores për organizimin e kohës së punës së personave që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1054, datë 22.12.2010 “Mbi pajisjet e regjistrimit në transportin rrugor”).	Gjithsej 2 orë
Tema nr.6: Njohuri tekniko-profesionale të domosdoshme për nivelin e kualifikimit, për drejtimin racional të mjetit me motor dhe rimorkiove, për të garantuar siguri në qarkullimin rrugor dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet.	Gjithsej 10 orë
1. Njohja e karakteristikave të sistemit të transmetimit të lëvizjes për një përdorim sa më të mirë që të jetë e mundur të mjetit.	orë 1 (një)
2. Grafikat që kanë lidhje me momentin e përdredhjes, energjinë dhe konsumimin specifik të një motori, zonën e përdorimit optimal të numrit të rrotullimeve, diagrama përmbledhëse e raporteve të trasmisionit në kutinë e shpejtësisë.	orë 1 (një)
3. Njohja e karakteristikave teknike dhe funksionimit të mjetit, të minimizojë konsumin dhe prishjen dhe të parandalojë keqfunksionimin e tij.	orë 1 (një)
4. Veçoritë specifike të qarkut të frenave ndihmëse me presion hidraulik, kufijtë në përdorimin e frenave dhe ngadalësimin, përdorimi i mirë i shpejtësisë dhe marsheve, përdorimi i inercisë së mjetit, mënyrat e zvogëlimit të shpejtësisë dhe frenimit në rrugë zbritëse, veprimi në rastin e dështimit	orë 1 (një)
5. Aftësia për të optimizuar konsumimin e karburantit.	orë 1 (një)
6. Aftësia për të ngarkuar mjetin me kujdesin e duhur, në përputhje me rregullat e sigurisë dhe përdorimin e duhur të tij.	orë 1 (një)
7. Forcat që ndikojnë mbi mjetet në lëvizje, përdorimin e raportit të kutisë së	



- shpejtësisë në përputhje me ngarkesën e mjetit dhe profilin e rrugës, përlogaritjen e ngarkesës së mjetit, përlogaritja e vëllimit total, shpërndarja e ngarkesës, pasojat e mbingarkimit të boshtit, qëndrueshmëria e mjetit dhe qendra e gravitetit, tipat e paketimit dhe paletët. orë 1 (një)
8. Kategoritë kryesore të mallrave që kanë nevojë për sigurim, teknikat e grumbullimit dhe të sigurimit, përdorimi i rripave të sigurimit, kontrolli i pajisjeve të sigurimit, përdorimi i pajisjeve të manovrimit, vendosja dhe zëvendësimi i tendave. orë 1 (një)
9. Aftësia për të siguruar rehatinë dhe sigurinë e pasagjerit: përshtatja e lëvizjeve gjatësore dhe anësore, ndarja e rrugës, pozicioni në rrugë, frenimi i butë, duke përdorur infrastruktura të veçanta (zonat publike, korsitë e dedikuara), menaxhimi i konflikteve mes drejtimit të mjetit në mënyrë të sigurt dhe roleve të tjera si një drejtues mjeti, duke ndërvepruar me pasagjerët, veçoritë e grupeve të caktuara të pasagjerëve (persona me aftësi të kufizuar, fëmijë). orë 2 (dy)
- Tema nr. 7: Aplikimi i rregullave Gjithsej 4 orë
1. Njohja e mjedisit social të transportit rrugor dhe rregullat që e qeverisin atë: periudhat maksimale të punës specifike për industrinë e transportit; parimet, zbatimi dhe pasojat e rregulloreve (EEC) nr.561/2006 dhe (EEC) nr.3821/85; gjohat për mospërdorim, përdorim të papërshtatshëm dhe ngatërresat me tahografin; njohuri mbi mjedisin social të transportit rrugor: të drejtat dhe detyrimet e drejtuesve të mjeteve në përputhje me kualifikimet fillestare dhe trajnimin periodik. orë 2 (dy)
2. Njohja me rregullat që menaxhojnë transportin e mallrave: lejet e operimit në transport, detyrimet nën kontratat standarde për transportin e mallrave, hartimi i dokumenteve të cilat formojnë kontratën e transportit, lejet e transportit ndërkombëtar, detyrimet nën Konventën mbi kontratën për transportin ndërkombëtar të mallrave në rrugë, duke hartuar njoftimin e ngarkesës ndërkombëtare që kalon kufijtë, përcjelljen e ngarkesave të mallrave, dokumente të veçanta që shoqërojnë mallrat. orë 1 (një)
3. Njohja me rregullat që menaxhojnë transportin e pasagjerëve: transporti i grupeve specifike të pasagjerëve, pajisjet e sigurisë në autobusë, rripat e sigurisë, ngarkesa e mjetit. orë 1 (një)
- Leksion nr.8: Shëndeti, siguria në rrugë dhe e mjedisit, shërbimet dhe logjistika. Gjithsej 8 orë
1. Ndërgjegjësimi i drejtuesve të mjeteve ndaj rreziqeve të rrugës dhe aksidenteve në punë: tipat e aksidenteve në punë në sektorin e transportit, statistikat e aksidenteve në rrugë, përfshirja e kamionëve/veturave, njerëzve, pasojave materiale dhe financiare. orë 1 (një)
2. Parandalimi i kriminalitetit dhe i trafikimit të emigrantëve të paligjshëm: informacion i përgjithshëm, problemet për drejtuesit e mjeteve, masat parandaluese, lista e kontrolleve, legjislacioni mbi detyrimet e operatorëve të transportit orë 1 (një)
3. Aftësia për të parandaluar rreziqet fizike, lëvizje dhe qëndrime të cilat paraqesin rrezik, përshtatje fizike, trajtimi i ushtrimeve, mbrojtja personale. orë 1 (një)
4. Informimi mbi rëndësinë e aftësive fizike dhe mendore: parimet e shëndetshme, të ushqyerit e balancuar, efektet e alkoolit, drogave dhe substancave të tjera të ngjashme që ndikojnë sjelljen, simptomat, shkaqet, efektet e lodhjes dhe stresit, roli themelor i punës bazë/fazës së pushimit. orë 1 (një)
5. Vlerësimi i situatës së emergjencës: sjellja në një situatë emergjence: vlerësimi i situatës, që shmang ndërlikimet e një aksidenti, thirrja për ndihmë, ndihmesa e të dëmtuarve dhe dhënia e ndihmës së parë, reagimi në rast zjarri, evakuimi i pasagjerëve të një kamioni/autobusi, duke garantuar sigurinë e të gjithë

- pasagjerëve, reagimin në rast sulmi; parimet bazë për hartimin e një raport aksidenti. orë 1 (një)
6. Aftësia për të përshtatur sjelljen në ndihmë të rritjes së imazhit të kompanisë: sjellja e drejtuesit të mjetit dhe imazhi i kompanisë: rëndësia e standardit të shërbimit siguruar nga drejtuesi i mjetit për kompaninë, rolet e drejtuesit të mjetit, njerëzit me të cilët ka të bëjë drejtuesi i mjetit, mirëmbajtja e mjetit, organizimi i punës, efektet komerciale dhe financiare të një diskutimi. orë 1 (një)
7. Njohja e mjedisit ekonomik të transportit rrugor dhe organizimi i tregut: transporti rrugor në lidhje me mënyrat e tjera të transportit (konkurrenca, transportuesit e mallrave), aktivitetet e ndryshme të transportit rrugor (transporti me qira ose shpërblim, llogari të vet, aktivitetet ndihmëse të transportit), organizimi i tipave kryesorë të kompanive të transportit dhe aktiviteve ndihmëse të transportit, specializime të ndryshme transporti (kamion rrugor, temperatura e kontrolluar, etj.), ndryshimet në industri (shumëllojshmëria e shërbimeve të siguruara, hekurudhat, nënkontraktues, etj.). orë 1 (një)
8. Njohja me mjedisin ekonomik të transportit të pasagjerëve në rrugë dhe organizimin e tregut: transporti i pasagjerëve në rrugë në lidhje me mënyrat e tjera të transportit të pasagjerëve (hekurudhë, makinë private), aktivitetet e ndryshme që përfshijnë transportin e pasagjerëve në rrugë, kalimin e kufijve (transporti ndërkombëtar), organizim i tipave kryesorë të kompanive për transportin e pasagjerëve në rrugë. orë 1 (një)
- Tema nr.9: Njohuri tekniko-profesionale për veprimtarinë e riparimit dhe mirëmbajtjes së pjesëve mekanike dhe të motorit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, për të garantuar siguri në qarkullimin rrugor dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet. Gjithsej 14 orë
- a) Mjeti rrugor, identifikimi dhe ndërtimi i tij orë 2 (dy)
- b) Motorët me djegie të brendshme orë 3 (tre)
- Llojet e motorëve me djegie të brendshme,
- Ndërtimi, funksionimi, shërbimet teknike, defektet e mundshme dhe mundësia e riparimit të tyre.
- c) Mekanizmi i transmetimit të fuqisë: orë 3 (tre)
- llojet,
- ndërtimi,
- karakteristikat e sistemit të transmetimit, funksionimi dhe përdorimi sa më efektiv i tij.
- d) Shasia dhe karrocëria, mekanizmi i drejtimit, i lëvizjes, i frenimit, gomat dhe suspensionet, llojet, ndërtimi, funksionimi, defektet dhe eliminimi i tyre orë 3 (tre)
- e) Sistemi elektrik, i ndezjes i ushqimit, llojet, ndërtimi, funksionimi, defektet dhe eliminimi i tyre orë 3 (tre)
- II. Programi praktik
- Programi praktik mësimor që do të aplikohet nga autoshkollat për përgatitjen e aplikantëve që do të kërkojnë të pajisen me Certifikatën e Aftësisë Profesionale do të zhvillohet në 10 orë mësimi respektivisht sipas temave të mëposhtme:
- Tema nr.1: Ngarkimi i mjetit, kujdesi për sistemimin e ngarkesës, lëvizja dhe manovrimi i tij me ngarkesë në kushtet e sigurisë së garantuar Gjithsej 5 orë
- aftësia për të ngarkuar mjetin me kujdesin e duhur për rregullat e sigurisë dhe përdorimin e duhur të mjetit, orë 1 (një)
- forcat që ndikojnë mbi mjetet në lëvizje, përdorimin e raportit të kutisë së shpejtësisë në përputhje me ngarkesën e mjetit dhe profilin e rrugës, përlllogaritjen e ngarkesës së mjetit , përlllogaritja e vëllimit total, shpërndarja e ngarkesës, pasojat e mbingarkimit të boshtit, qëndrueshmëria e mjetit dhe qendra e gravitetit, orë 2 (dy)
- tipat e paketimit dhe paletet,



- kategoritë kryesore të mallrave që kanë nevojë për sigurim, teknikat e grumbullimit dhe sigurimit, përdorimi i rripave të sigurimit, kontrolli i pajisjeve të sigurimit, përdorimi i pajisjeve të manovrimit, vendosja dhe zëvendësimi i tendave. orë 2 (dy)
- Tema nr.2: Aftësia për të siguruar rehatinë dhe sigurinë e pasagjerit në transportin e udhëtarëve Gjithsej 5 orë
- përshtatja e lëvizjeve gjatësore dhe anësore, ndarja e rrugës, pozicioni në rrugë, frenimi i butë, duke përdorur infrastruktura të veçanta (zonat publike, korsitë e dedikuara), orë 2 (dy)
 - menaxhimi i konflikteve mes drejtimit të mjetit në mënyrë të sigurt dhe roleve të tjera si një drejtues mjeti, duke ndërvepruar me pasagjerët. orë 2 (dy)
 - veçoritë e grupeve të caktuara të pasagjerëve (persona me aftësi të kufizuar, fëmijë). orë 1 (një)

Shënim: Kjo çertifikatë është e vlefshme në përputhje me Direktivën e BE 2003/59/EC nëse shoqërohet me Lejen Kombëtare të Drejtimit.

Note: This certificate is valid in accordance with EU Directives 2003/59/EC if it is accompanied by the National Driver License.

Tipi KC, për drejtues të automjeteve të kategorisë C.
Type KC, for drivers of vehicles of category C.

Tipi KC+E, për drejtues të automjeteve të kategorisë CE.
Type KC+E, for drivers of vehicles of category CE.

Tipi KD, për drejtues të automjeteve të kategorisë D.
Type KD, for drivers of vehicles of category D.

Tipi KD+E, për drejtues të automjeteve të kategorisë DE.
Type KD+E, for drivers of vehicles of category DE.

- Çdo korrigjim e bën të pavlefshme këtë çertifikatë.

Çertifikata është e vlefshme 5 vjet nga data e lëshimit.
Certificate is valid 5 years from date of issue.



Ser.NR.: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR



ÇERTIFIKATË E AFTËSISË PROFESIONALE (ÇAP)
Certificate of Professional Competence (CPC)

Nr. _____

TIPI / TYPE

KC	KC+E	KD	KD+E

Ser.NR.: _____



<div data-bbox="568 343 996 726" style="border: 1px solid black; padding: 10px; text-align: center;"><p>Foto 3.5 x 4.2</p></div> <p>1. Emri: Name: _____</p> <p>2. Mbiemri: Surname: _____</p> <p>3. Atësia: Father: _____</p> <p>4. Datëlindja: Date of birth: _____</p> <p>5. Vendbanimi: Place of birth: _____</p>	<p>5. Nr.Leje Drejtimi _____ Driving Licence number</p> <p>6. Lëshohet në bazë të vendimit të Issued by decision of testing commission komisionit të testimit</p> <p>KC Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____</p> <p>KC+E Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____</p> <p>KD Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____</p> <p>KD+E Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____</p> <p>8. Data e lëshimit ____/____/____ Issue date</p> <p>9. E vlefshme deri më ____/____/____ Valid until</p> <p>10. Lëshohet nga DPSHTRR Issued by DPSHTRR</p> <p style="text-align: center;">Drejtori i Përgjithshëm General Director</p> <p style="text-align: center;">_____</p>
---	---

Shënim: Kjo çertifikatë është e vlefshme në përputhje me Direktivën e BE 2003/59/EC nëse shoqërohet me Lejen Kombëtare të Drejtimit.

Note: This certificate is valid in accordance with EU Directives 2003/59/EC if it is accompanied by the National Driver License.

Tipi KC, për drejtues të automjeteve të kategorisë C.
Type KC, for drivers of vehicles of category C.

Tipi KC+E, për drejtues të automjeteve të kategorisë CE.
Type KC+E, for drivers of vehicles of category CE.

Tipi KD, për drejtues të automjeteve të kategorisë D.
Type KD, for drivers of vehicles of category D.

Tipi KD+E, për drejtues të automjeteve të kategorisë DE.
Type KD+E, for drivers of vehicles of category DE.

- Çdo korrigjim e bën të pavlefshme këtë çertifikatë.

Çertifikata është e vlefshme 5 vjet nga data e lëshimit.
Certificate is valid 5 years from date of issue.



Ser.NR.: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR

AL

ÇERTIFIKATË E AFTËSISË PROFESIONALE (ÇAP)
Certificate of Professional Competence (CPC)

Nr. _____

TIPI / TYPE

KC	KC+E	KD	KD+E

Ser.NR.: _____



<p style="text-align: center;">Foto 3.5 x 4.2</p> <p>1. Emri: Name: _____</p> <p>2. Mbiemri: Surname: _____</p> <p>3. Atësia: Father: _____</p> <p>4. Datëlindja: Date of birth: _____</p> <p>5. Vendbanimi: Place of birth: _____</p>	<p>5. Nr. Leje Drejtimi _____ Driving Licence number</p> <p>6. Lëshohet në bazë të vendimit të komisionit të testimit Issued by decision of testing commission</p> <p>KC Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____</p> <p>KC+E Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____</p> <p>KD Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____</p> <p>KD+E Nr. _____ Prot. Dt. ____/____/____</p> <p>8. Data e lëshimit ____/____/____ Issue date</p> <p>9. E vlefshme deri më ____/____/____ Valid until</p> <p>10. Lëshohet nga DPSHTRR Issued by DPSHTRR</p> <p style="text-align: center;">Drejtori i Përgjithshëm General Director</p> <p style="text-align: center;">_____</p>
--	--

VENDIM
Nr.46, datë 4.11.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	anëtar	i	Gjykatës Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	anëtare	e	“ “
Sokol Sadushi	anëtar	i	“ “
Sokol Berberi	anëtar	i	“ “
Admir Thanza	anëtar	i	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“ “
Petrit Pllaçi	anëtar	i	“ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 17.5.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.13 Akti, që i përket:

KËRKUES: Klodian Zeka, përfaqësuar nga avokat Skënder Breca, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr.950, datë 30.10.2009, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr.974, datë 10.11.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Petrit Pllaçi; përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.400, datë 20.4.2004, ndër të tjera, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuarit për veprat penale të “trafikimit të femrave për prostitucion”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe të “marrëdhënies seksuale me dhunë me të mitura të moshës 14-18 vjeç” parashikuar nga nenet 114/b-2 e 22, 101/1 të Kodit Penal (KP), duke e dënuar me 16 vjet burgim. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 764, datë 11.11.2004, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.400, datë 20.4.2004, dhe duke e deklaruar fajtor kërkuarin e ka dënuar atë me 10 vjet burgim. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.540, datë 8.7.2005, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari. Hetimi, gjykimi dhe dhënia e këtyre vendimeve është bërë në mungesë të kërkuarit, i cili ka qënë i përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar me prokurë prej nënës së tij.

Në datën 25.4.2008, rezultoi se është ekzekutuar vendimi i dënimit i dhënë në mungesë të kërkuarit. Me ekzekutimin e vendimit të mësipërm, bazuar në një akt përfaqësimi të lëshuar nga kërkuari, avokati i caktuar prej tij ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Tiranës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 400, datë 20.4.2004 dhe kjo gjykatë me vendimin nr.787 të aktit, datë 5.1.2008, ka vendosur pranimin e kërkesës të kërkuarit dhe rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit nr.400, datë 20.4.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pas këtij vendimi kërkuari ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.950, datë 30.10.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.400, datë 20.4.2004.



Mbi rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.974, datë 10.11.2010, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk është respektuar dispozita në lidhje me formën. Ky Kolegj e ka arsyetuar vendimin tij me faktin se rekursi i paraqitur është nënshkruar nga vetë kërkuari dhe jo nga mbrojtësi i tij, çka, sipas këtij Kolegji, bazuar në nenin 475/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe në vendimin nr.5 datë 15.9.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sjell për pasojë mospranimin e rekursit.

Kërkuari ka pretenduar para Gjykatës Kushtetuese se vendimet e kundërshtuara janë marrë në cenim të së drejtës së tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor për arsye se:

- Gjykata e Apelit ka cenuar parimin e mosdënimit më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe të mosgjykimit sërish, parashikuar nga neni 34 i Kushtetutës, sepse duke qenë në fuqi vendimi nr.764, datë 11.11.2004 i Gjykatës së Apelit dhe vendimi nr.540, datë 8.7.2005, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kjo gjykatë rishqyrtoi të njëjtën vepër penale, duke e dënuar kërkuarin më shumë se një herë.

- Gjykata e Apelit ka cenuar parimin e mosrëndimit të pozitës, parashikuar nga neni 425/3 i KPP-së, për shkak se, duke e rimarrë çështjen në shqyrtim, kjo gjykatë ka lënë në fuqi vendimin nr.400, datë 20.4.2004 të gjykatës së shkallës së parë, që e kishte dënuar atë me 16 vjet burgim, dënim ky që ishte më i rëndë se dënimi i dhënë me vendimin e mëparshëm nr.764, datë 11.11.2004 të kësaj gjykate.

- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin objekt kundërshtimi, duke i mohuar kërkuarit të drejtën për t'u dëgjuar për shkaqet e ngritura në rekurs, ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë. Kërkuari ka arsyetuar se mungesa e nënshkrimit të mbrojtësit në rekursin e ushtruar prej tij, nuk mund të sjellë mohimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për shkaqet e ngritura.

II

1. Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit në gjykatë)

Kërkuari Klodian Zeka, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), ka pretenduar se Gjykata e Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se në kundërshtim me nenin 435/2 të KPP-së, ky akt nuk ishte nënshkruar nga mbrojtësi i tij, i ka cenuar atij të drejtën për t'iu drejtuar kësaj gjykate, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

Gjykata, në këtë drejtim, rithekson se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës (aksesi në gjykatë) është element përbërës i së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës europiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ). Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së (*shih vendimet nr.38, datë 30.12.2010; nr.5, datë 2.3.2011, nr.8, datë 16.3.2011; nr.9, datë 29.03.2011; nr.10, datë 29.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata rithekson megjithatë se e drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë objekt kufizimesh (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi), por këto kufizime nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e të drejtës. Gjykata është shprehur, gjithashtu, se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç sanksionohet në KPP, përbën një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi/mosgjykimi në themel i shkaqeve të rekursit, cenon të drejtën e aksesit të tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 24.7.2006*). Në këtë aspekt, Gjykata çmon se edhe parashikimi ligjor i nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale nuk mund të interpretohet në një mënyrë të tillë, që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë. Në lidhje me interpretimin e ligjit, Gjykata

rithekson se pretendimet për zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit, mund të merren në shqyrtim prej saj vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejtat kushtetuese themelore për një proces të rregull ligjor (*shih vendimet nr.35, datë 20.12.2005 dhe nr.4, datë 28.2.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë arsye, Gjykata, për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, zbatimin e nenit 435/2 të KPP-së e ka parë në raport me rregullimet e përgjithshme që dispijlojnë paraqitjen e ankimit (nenet 407- 421 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të Kodit të Procedurës Penale). Kështu, Gjykata, në vendimin nr.26, datë 13.6.2011, si dhe në vendime të tjera të saj është shprehur se neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon, *inter alia*, se akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen nga mbrojtësit, me pasojë mospranimi, nuk mund të interpretohet nga Gjykata e Lartë në një mënyrë të tillë që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate. Qëllimi i këtij neni është të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Standardi i mbrojtjes me avokat në Gjykatën e Lartë, i cili njihet edhe si *procesi i avokatit*, nuk garantohet plotësisht nëse respektohet vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Rekursi është akti procedural, në të cilin parashtrohen shkaqet e kundërshtimit të një vendimi sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohej e drejta për akses në Gjykatën e Lartë.

Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, para se të vendosë mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që vetë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.5, datë 15.9.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr.38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim, kërkuesi Klodian Zeka ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs i cili nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi i tij. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, sipas kërkesave të nenit 435/2 të KPP-së. Nga materialet e paraqitura para Gjykatës Kushtetuese dhe debati gjatë seancës gjyqësore, nuk rezulton që sekretaria gjyqësore të ketë përmbushur detyrimin për vënien në dijeni të kërkuesit për mosplotësimin e kërkesës formale të nënshkrimit të rekursit nga mbrojtësi, në mënyrë që ai të mund të bënte plotësimet e nevojshme.

Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesi me arsyetimin se nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, i ka cenuar atij të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë.

2. Lidhur me pretendimet e cenimit të parimit të mosgjyqimit sërish dhe mosdënimit më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe të mosrëndimit të pozitës

Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Apelit, në dhënien e vendimit objekt kundërshtimi kushtetues, ka shkelur parimin e mosgjyqimit sërish dhe mosdënimit më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe të mosrëndimit të akuzës.

Gjykata Kushtetuese, gjatë votimit të çështjes mbi këto pretendime, për arsye se votat u ndanë në mënyrë të barabartë, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/1 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 74 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", konkludon se kërkesa për shfuqizimin e vendimit nr.950, datë 30.10.2009, të Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të refuzohet.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.974, datë 10.11.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

- Refuzimin e kërkesës për shfuqizimin e vendimit nr.950, datë 30.10.2009, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Petrit Ploçi, Altina Xhoxhaj.

VENDIM

Nr.47, datë 7.11.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Petrit Ploçi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Sokol Berberi	anëtar I	“	“
Admir Thanza	anëtar I	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Sokol Sadushi	anëtar i	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 9.6.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, me dyer të hapura, çështjen nr. 20 Akti, që i përket:

KËRKUES: Orik Shyti, përfaqësuar nga avokat Dylber Mani, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga Artur Selmani, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si antikushtetues, i vendimeve: nr.44, datë 1.7.2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr.40, datë 7.7.2009 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe nr. 00-2010-933 (731), datë 2.7.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 32, 34, 42/2, 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës europiane për të drejtat e njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Sokol Sadushi, kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës, subjektin e interesuar që u shpreh për rrëzimin e saj dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I

1. Kërkuesi është akuzuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, së bashku me të pandehur të tjerë, për kryerjen e një sërë veprash penale, kryesisht në Tiranë e Vlorë, gjatë viteve 1993–1996. Për këto episode kriminale fillimisht janë regjistruar procedime penale në Prokurorinë e Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Vlorë, të cilat në datën 24.10.1996 janë bashkuar në një procedim të vetëm (nr.1589) nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky procedim penal është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 13.11.1998. Me vendim nr.106, datë 12.2.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e çështjes, pasi ka interpretuar si tërheqje akuze kërkesën e prokurorisë për kalim aktesh në prokurori, për kryerje të hetimeve të mëtejshme, duke i'u referuar nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr.252, datë 30.4.2003, ka vendosur prishjen e vendimit nr.106, datë 12.2.2003, *supra*, kthimin e çështjes për rigjykim me trup tjetër gjykues dhe ka kërkuar në pjesën arsyetuese, që ky trup i ri gjykues të respektojë nenin 377 dhe t'ia kalojë aktet Prokurorisë, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga kërkuesi me anë të mbrojtësit të tij dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me motivacionin se “nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas kthimit të çështjes për rigjykim, me vendim nr.744, datë 4.9.2003, ka vendosur kalimin e akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila pas kryerjes së disa veprimeve hetimore të tjera, ka shpallur moskompetencën e mëtejshme lëndore të saj për hetimin e çështjes dhe ja ka përcjellë aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

2. Pas regjistrimit të procedimit penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e ka dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (nr.106 akti, datë 14.9.2004, *supra*). Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, pas administrimit të provave për secilin nga episodet kriminale, objekt gjykimi, me vendimin nr. 44, datë 1.7.2008, ka vendosur ta shpallë fajtor kërkuesin për veprat penale si vijon: **a)** “Vjedhje me armë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të firmës “Vefa”; **b)** “Vjedhje me armë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të degës së Bankës Kombëtare Tregtare Vlorë; **c)** “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, me pasojë vdekjen e shtetasit Bujar Kaloshi; **ç)** “Vjedhje me dhunë” në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të argjendarisë “Agron”; **d)** “Vjedhje me dhunë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shoqërisë “IAP”; **dh)** Vjedhje me dhunë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shoqërisë “IAP” (e përsëritur); **e)** “Vrasje me dashje e kryer për interes” e mbetur në tentativë, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shtetasit Eduart Trimi; **ë)** “Vjedhje me pasojë vdekjen”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shtetasit Pirro Konini; **f)** “Vjedhje me dhunë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shoqërisë “Albfoam”; **g)** “Vjedhje me dhunë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të Ndërmarrjes së Lëndëve Djegëse; **gj)** “Vjedhje me pasojë vdekjen”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shtetasit Sami Jata; **h)** “Vjedhje me dhunë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të firmës “Shkumbin Petrol”; **i)** “Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të Degës së Bankës së Kursimeve Vlorë; **j)** “Rrëmbim ose mbajtje peng e personit në rrethana lehtësuese”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të fëmijës Erion Nushi; **k)** “Vepra të dhunshme ndaj pasurisë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale; **l)** “Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të viktimës Vera Dume; **ll)** “Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të viktimës Hasim Karamani; **m)** “Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër”, në bashkëpunim, në formën e



organizatës kriminale, në dëm të viktimës Vait Osmani; **n**) “Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të viktimës Muhamet Karamani; **nj**) “Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të degës së Bankës së Kursimeve Tiranë; **o**) “Falsifikim i dokumenteve”; **p**) “Falsifikim i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave”; pushimin e çështjes penale për veprën penale “Falsifikim të akteve të gjendjes civile”, për shkak amnistie, dhe në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 55 të Kodit Penal, për caktimin e dënimeve për disa vepra penale, ka vendosur të dënojë kërkuesin me burgim të përjetshëm.

3. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.40, datë 7.7.2009, ka vendosur:

i) Lënien në fuqi të vendimit nr.44, datë 1.7.2008, në lidhje me kualifikim ligjor, fajësinë e kërkuesit dhe masat e dënimit për veprat penale, si vijon:

- “Vjedhje me armë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të firmës “Vefa” **(a)**;

- “Vjedhje me armë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të Degës së Bankës Kombëtare Tregtare Vlorë **(b)**;

- “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, me pasojë vdekjen e shtetasit Bujar Kaloshi; **(c)**;

- “Vjedhje me dhunë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të argjendarisë “Agron” **(ç)**;

- “Vjedhje me dhunë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shoqërisë “IAP” **(d)**;

- “Vjedhje me dhunë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shoqërisë “Albfoam” **(f)**;

- “Vjedhje me dhunë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të Ndërmarrjes së Lëndëve Djegëse **(g)**;

- “Vjedhje me dhunë”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të firmës “Shkumbin Petrol” **(h)**;

- “Rrëmbim ose mbajtje peng e personit në rrethana lehtësuese”, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të fëmijës Erion Nushi; **(j)**;

- “Falsifikim i dokumenteve” **(o)**;

- “Falsifikim i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave” **(p)**; si dhe pushimin e çështjes për veprën penale “Falsifikim të akteve të gjendjes civile”.

ii) Ndryshimin e vendimit nr. 44, datë 1.7.2008, për veprat penale, si vijon (shih paragrafin 2, *supra*):

- “Vjedhje me dhunë” në dëm të shoqërisë “IAP” **(dh)** dhe “Vrasje me dashje e kryer për interes” e mbetur në tentativë **(e)** ndryshohen në “Grabitje” sipas Kodit Penal të vitit 1977 dhe Kodit Penal të kohës së kryerjes së veprës; dënimi ndryshohet nga 7 dhe 12 vjet burgim, në një dënim unifikues për të dyja veprat³ prej 15 vjetësh;

- “Vjedhje me pasojë vdekjen” në dëm të shtetasit Pirro Konini **(ë)** ndryshohet në ‘Grabitje me pasojë vdekjen’ sipas Kodit Penal të vitit 1977 dhe Kodit Penal të kohës së kryerjes së veprës; dënimi ndryshohet nga burgim i përjetshëm në 25 vjet burgim;

- “Vjedhje me pasojë vdekjen” në dëm të shtetasit Sami Jata **(gj)**, ndryshohet në “Grabitje me pasojë vdekjen” sipas Kodit Penal të vitit 1977 dhe Kodit Penal të kohës së kryerjes së veprës; dënimi ndryshohet nga 22 vjet burgim në 20 vjet;

- Dënimi për “Vjedhjen e bankave dhe arkave të kursimit” në dëm të degës së Bankës së Kursimeve Vlorë **(i)** dhe “Vjedhjen e bankave dhe arkave të kursimit” në dëm të degës së Bankës së Kursimeve Tiranë **(nj)** ndryshohet nga 10 dhe 12 vjet burgim në një dënim unifikues për të dyja veprat penale prej 15 vjetësh;

³ Këto vepra kanë lidhje shkakësore me njëra tjetrën.

- “Vepra të dhunshme ndaj pasurisë” (k); “Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër” në dëm të viktimës Vera Dume, (I); “Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër” në dëm të viktimës Hasim Karamani, (II); “Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër” në dëm të viktimës Vait Osmani, (m); “Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër” në dëm të viktimës Muhamet Karamani, (n); ndryshohet në “Vepër me qëllime terroriste” sipas Kodit Penal në fuqi dhe dënimi i dhënë është burgim i përjetshëm;

dhe përfundimisht e ka dënuar kërkuesin me burgim të përjetshëm.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2010-933 (731), datë 2.7.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

5. Kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (në vijim Gjykata), ku kërkon shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.44, datë 1.7.2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, vendimit nr.40, datë 7.7.2009 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe vendimit nr.00-2010-933 (731), datë 2.7.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

6. Kërkuesi ka parashtruar përpara Gjykatës se:

6.1 Është gjykuar sërish për të njëjtat vepra penale, në kundërshtim me nenin 34 të Kushtetutës, Konventën europiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ) dhe nenin 7 të KPP-së;

6.2 Është gjykuar tej çdo afati të arsyeshem, në kundërshtim me nenin 42/2 të Kushtetutës dhe nenin 6, pika 1 të KEDNJ-së;

6.3 Është deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, në kundërshtim me nenin 32/2 të Kushtetutës dhe nenet 5/2, 128, 129, 151/4 dhe 370/2 të KPP-së;

6.4 Gjykata ka shkelur parimin e barazisë së armëve, duke mos administruar prova të kërkuara nga mbrojtja dhe duke mos arsyetuar vendimet, në kundërshtim me nenet 142/1 të Kushtetutës dhe nenet 112/3, 383/1 dhe 384/1 të KPP-së;

6.5 I është shkelur e drejta për t’u prezumuar i pafajshëm, në kundërshtim me nenin 30 të Kushtetutës, nenin 6/2 të KEDNJ-së si dhe nenet 4 dhe 3/2 të KPP-së;

6.6 Është shkelur parimi i paanshmërisë së gjykatës, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kryesohej nga z. Gani Dizdari, i cili ka qenë zv/Prokuror i Përgjithshëm në kohën kur ka filluar procedimi i parë penal ndaj kërkuesit (nr.1589, datë 13.10.1996) dhe në këtë cilësi ka kryer veprime që lidhen me këtë procedim penal.

7. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Përgjithshme, ka parashtruar me shkrim dhe në seancën plenare prapësimet në këto drejtime kryesore:

7.1 Nuk është cenuar parimi *ne bis in idem*, pasi vendimi nr.106, datë 12.2.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka vendosur pushimin e çështjes, nuk është i formës së prerë;

7.2 Provat e marra në gjykim nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk janë marrë në kundërshtim me ligjin;

7.3 Çështja ka qenë komplekse dhe për këtë arsye procesi gjyqësor ka qenë i gjatë, por sidoqoftë nuk ka marrë një kohë tej asaj kohe që përdoret për trajtimin nga sistemi gjyqësor shqiptar i çështjeve penale të ngjashme;

7.4 Pretendimi i shkeljes së barazisë së armëve nuk është argumentuar nga kërkuesi;

7.5 Gjykatat nuk e kanë filluar procesin duke e prezumuar kërkuesin të fajshëm;

7.6 Vendimet e gjykatave, duke përfshirë dhe vendimin e Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, janë të arsyetuara.

II

A. Për pretendimin e gjykimit tej një afati të arsyeshem

8. Kërkuesi pretendon se është gjykuar *tej çdo afati të arsyeshem*, duke argumentuar se procesi penal ndaj tij ka filluar që në vitin 1996 dhe vendimi i formës së prerë mban datën 2.7.2009. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve



duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 19.7.2005; nr.35, datë 27.10.2010; nr.12, datë 15.4.2011*).

9. Nga një shqyrtim i hollësishëm i materialeve të dosjes gjyqësore është i kuptueshëm kompleksiteti i procesit gjyqësor në fjalë, duke pasur parasysh numrin e të pandehurve dhe të akuzave të veçanta për secilin, rrethanat e çështjes, kohën që i është dashur prokurorisë për mbledhjen e provave dhe formulimin e akuzave. Autoritetet gjyqësore dhe ato të ndjekjes penale (bashkërisht “organi procedues”) kanë shqyrtuar një numër të madh dokumentesh për secilin nga personat e përfshirë në proces. Natyra e akuzave dhe problemet e kompetencës në lidhje me organet e ndjekjes penale, që kanë dalë në pah gjatë procesit, e kanë bërë edhe më komplekse çështjen. Përveç sa më sipër, Gjykata çmon se në zgjatjen e procesit ka ndikuar edhe fakti që kjo çështje, mbi bazën e ankimeve, ka kaluar dy herë të gjitha instancat gjyqësore.

10. Gjatë procesit gjyqësor në ngarkim të kërkuesit janë zhvilluar një numër i konsiderueshëm seancash gjyqësore. Nga procesverbalet e seancave provohet se për të njoftuar kërkuesin dhe të pandehurit e tjerë, seancat gjyqësore janë ndërprerë disa herë në respektim të neneve 139, 351/4, 351/1 dhe 352/2 të KPP-së. Pas përpjekjeve për të njoftuar kërkuesin, fillimisht në banesën e tij ku nuk u gjet e më pas me anë të letërporosive në shtetet ku rezultonte të ishte, Gjykata e Krimeve të Rënda, pasi krijoi bindjen se kërkuesi ishte në dijeni të procesit në ngarkim të tij, e deklaroi atë në mungesë. Periudha kohore, duke filluar nga data 14.9.2004 deri në datën 7.3.2005, është konsumuar nga organi procedues për njoftimin e të pandehurve. GJEDNJ-ja ka nënvizuar se në çështjet penale “afati i arsyeshëm”, të cilit i referohet neni 6§1 i KEDNJ-së, fillon nga momenti që një person është i “akuzuar” për një vepër penale; kjo mund të ndodhë në një datë para se çështja të vijë para gjykatës, siç mund të jetë data e arrestimit, data kur personi në fjalë është njoftuar zyrtarisht se ai do të ndiqet penalisht ose data kur janë hapur hetimet paraprake (*shih çështjet Von Hoffen kundër Litenshtejnit, 2 korrik 2006 §.35; Hozee kundër Holandës, 22 maj 1998 § 43*). Në datën 10.10.1998, avokatit të kërkuesit i është njoftuar akuza dhe për efekt të vlerësimit të afatit të arsyeshëm të procesit gjyqësor është kjo datë e cila merret parasysh si moment i fillimit të këtij afati.

11. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve kompetente, Gjykata çmon se një numër i madh seancash janë shtyrë, për arsye të cilat i atribuohen organit procedues (gjykata dhe prokuroria bashkërisht). Duke i'u referuar procesverbaleve të seancave në dosjen gjyqësore, konstatohet mungesa e gjyqtarëve për arsye objektive, ndër të cilat mund të përmendim pjesëmarrjen në gjykim të çështjeve të tjera, raportin shëndetësor apo marrjen e kohës për t'u njohur me çështjen. Seancat gjyqësore janë shtyrë edhe për mungesë të prokurorëve për shkaqe të lidhura kryesisht me zëvendësimin e tyre ose marrjen e kohës për t'u njohur me çështjen. Krahas mungesës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, vërehet se seancat janë shtyrë edhe për arsye të mungesës së sekretares së gjykatës. Në këto kushte, Gjykata nënvizon se sjellja e organit procedues në tërësi ka shkakuar vonesa në gjykim.

12. Sjellja e kërkuesit është marrë në konsideratë dhe është vlerësuar nga Gjykata në kompleksitet me kriteret e tjera të përcaktuara nga GJEDNJ-ja. Nga procesverbalet e seancave gjyqësore, vihet re se mungesa e mbrojtësit të kërkuesit apo mbrojtësve të të bashkëpandehurve të tjerë, kryesisht me motivacionin e pjesëmarrjes në gjyqë të tjera, është bërë shpesh shkak për shtyrjen e seancave. Në disa raste seancat janë shtyrë për arsye se nga ana e mbrojtjes nuk janë siguruar në kohë provat shkresore ose janë paraqitur të parregullta nga ana formale. Gjykata konstaton në çështjen konkrete se, në rastet e mungesës së mbrojtësve, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk është treguar pasive në lidhje me këtë sjellje të palës, por ka vënë në dijeni Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën e Avokatisë për marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve.

13. Në vijim të arsytimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se kompleksiteti i çështjes, sjellja e organit procedues dhe e kërkuesit janë bërë shkak për zgjatjen e procesit gjyqësor tej afateve të arsyeshme. Pavarësisht se vonesat, që i atribuohen organit procedues,

kanë ndodhur për shkaqe objektive dhe hapësirat legislative kanë lejuar rishqyrtimin e çështjes, në çmuarjen e Gjykatës, zvarritja e procesit nga autoritetet shtetërore është e pajustificueshme. Edhe pse në kushtet e mungesës së një mjeti juridik specifik për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga mosrespektimi i standardit kushtetues të afatit të arsyeshëm, Gjykata thekson se është detyrë e autoriteteve kompetente, duke përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme, gjykatat, Ministrinë e Drejtësisë, si dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të marrin masat për të siguruar miradministrimin e proceseve gjyqësore dhe mënjanimin e shtyrjeve së tyre tej afateve të arsyeshme.

14. Nisur nga sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, është i bazuar.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme

15. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi kryesuesi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka qenë Zëvendësprokuror i Përgjithshëm në kohën kur kërkuesi procedohej penalisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj dhe në këtë cilësi ka kryer veprime që lidhen me këtë procedim penal. Një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, është gjykimi i çështjes nga një gjykatë e paanshme. Gjykata merr parasysh, *inter alia*, veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk ofrojnë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Gjykata çmon se paragjykimi eventual për paanshmëri e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës, kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike, duhet ta krijojë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimin nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në Dhomën e Këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar i cili, në këndvështrimin objektiv, nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se "...thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar, se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje" (*shih vendimet nr.21, datë 29.4.2010; nr. 1, datë 25.1.2010; nr. 48, datë 30.7.1999 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Edhe GJEDNJ-ja e ka trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e saj respektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Në çështjen *Kyprianou kundër Qipros*, datë 15 dhjetor 2005, §118, GJEDNJ-ja ka theksuar se "është shumë e rëndësishme në një shoqëri demokratike që gjykata të ngjallë besim tek publiku dhe tek i akuzuari". Kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që pretendojnë anshmërinë është i rëndësishëm por jo vendimtar. Vendimtare është nëse ky shqetësim mund të konsiderohet objektivisht i justifikuar (*shih Ferrantelli and Santangelo, supra, § 58; Wettstein kundër Zvicrës, datë 21 dhjetor 2000, §44*). Në rastin konkret, pretendimi i kërkuesit për paanshmërinë e gjyqtarit ka karakter funksional; nuk goditet sjellja e tij, por ushtrimi i dy funksioneve nga i njëjti person brenda të njëjtit proces, që objektivisht justifikon dyshime në lidhje



me paanshmërinë e gjykatës. Sipas kërkesit, por edhe nga verifikimet e materialeve të dosjes, rezulton se Kryetari i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka ushtruar detyrën e prokurorit në gjyqin ndaj të atit të kërkesit, në vitin 1993, dhe detyrën e Zëvendësprokurorit të Përgjithshëm në kohën kur kishte filluar procedimi penal ndaj kërkesit.

18. Gjykata e çmon të arsyeshme të ndalet në rolin dhe pozitën kushtetuese të organit të prokurorisë, në strukturën institucionale shtetërore, si edhe kompetencat kushtetuese e ligjore të këtij institucioni. Kushtetutbërësi e ka njohur Prokurorinë si një organ të centralizuar, që në ushtrimin e kompetencave i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (*vendim nr.14, datë 21.7.2008 i Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka vlerësuar se “organi i prokurorisë ka disa veçori të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligj, të cilat e vendosin këtë organ në një pozitë të dallueshme nga pushtetet e tjera, dhe veçanërisht: **a)** si organi i vetëm në vend që ushtron ndjekjen penale; **b)** si organ që përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, që disponon mbi çështjet që ndodhen në gjykim dhe që është i lirë në kërkimin e llojit dhe të masës së dënimit ndaj personave që i rezultojnë fajtorë; **c)** si organ me pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve, duke iu nënshtuar vetëm Kushtetutës dhe ligjeve, gjë që do të thotë se fillimi i procedimit penal, vënia para përgjegjësisë penale, pushimi, pezullimi i çështjeve ose dërgimi në gjyq, janë attribute të prokurorisë; **ç)** si organ i centralizuar që funksionon sipas rregullit se urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët” (*shih vendimin nr.26, datë 4.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*)

19. Duke pasur parasysh çka më sipër, në lidhje me strukturën e centralizuar të Prokurorisë, që operon si një organ shtetëror unik dhe i pandashëm, Gjykata vlerëson si të mirëqenë faktin që Zëvendësprokurori i Përgjithshëm, për arsye të funksionit që mban, jo vetëm ka njohuri, por është i përfshirë në të gjitha çështjet që shqyrtohen nga Prokuroria e Përgjithshme dhe orientimet që jepen për to.

20. Nga materialet e paraqitura evidentohet se Kryetari i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në cilësinë e Zëvendësprokurorit të Përgjithshëm, ka firmosur disa shkresa që kanë lidhje me procedimin penal ndaj kërkesit. Më konkretisht, në shkresën nr.1392, datë 25.10.1196, drejtuar grupit të hetimit të çështjes penale në ngarkim të grupit “Hakmarrja shqiptare e drejtësisë”, përcaktohet procedura që duhet ndjekur lidhur me shpalljen e kërkimit ndërkombëtar për persona të kategorisë “shumë të kërkuar”. Në fund të shkresës, Zëvendësprokurori i Përgjithshëm shprehet me fjalët “do të kërkoni vendosjen e masës shtrënguese dhe ekstradimin” çka përbën dhënien e një urdhri të drejtpërdrejtë prokurorit të zakonshëm. Në shkresën nr.1413/40, datë 27.11.1996, Zëvendësprokurori i Përgjithshëm i kërkon Gjykatës së Rrethit Tiranë t’i vërë në dispozicion Prokurorisë së Përgjithshme materiale hetimore për zhvillimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal ndaj kërkesit. Me anë të shkresës nr.523, datë 12.8.1997, Zëvendësprokurori i Përgjithshëm i kthen përgjigje të ëmës së kërkesit në lidhje me gjendjen e autoveturave të sekuestruara në procedimin penal ndaj kërkesit.

21. Në vijim, duke pasur parasysh çka më sipër, Gjykata vlerëson se kur ekzistojnë kushtet që justifikojnë një dyshim të përligjur për anshmëri gjatë gjykimit, detyra e çdo gjyqtari është t’i shmanget gjykimit, në mënyrë që të mos cenohet rregullsinë e procesit gjyqësor për sa i përket aspektit të paanshmërisë së gjykatës. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se përfshirja e gjyqtarit në procesin penal ndaj kërkesit, kur ai ka ushtruar rolin e Zëvendësprokurorit të Përgjithshëm, nuk ka qenë e papërfillshme ndaj dhe dyshimi i kërkesit është i bazuar nga ana objektive. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkesit, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme, duhet pranuar.

C. Për pretendimet e tjera

22. Për sa i përket pretendimeve të tjera të kërkesit, Gjykata ka vlerësuar si vijon:

a) Në lidhje me pretendimin se është gjykuar dy herë për të njëjtat vepra penale

Kërkuesi pretendon se është gjykuar dy herë për të njëjtat vepra penale pasi sipas tij vendimi nr.106, datë 12.2.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është përfundimtar dhe përbën *res judicata*. Parimi *ne bis in idem*, është një instrument kryesor juridik, një garanci thelbësore e

individit, e përfshirë në dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut⁴, që rregullon marrëdhëniet në fushën penale të brendshme dhe ndërkombëtare. Ky parim nënkupton se asnjë individ nuk mund të gjykohet apo dënohet përsëri për të njëjtën veprë penale, për të cilën ai është shpallur i pafajshëm ose është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme. Sipas jurisprudencës kushtetuese, kriteri “e njëjta veprë” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, veprë penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj veprë dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar (*shih vendimet nr.33, datë 22.7.2011; nr.5, datë 8.3.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka çmuar *se res judicata* nënkupton, në aspektin formal e procedural, mosankueshmërinë e vendimit, ndërsa, në atë substancial, fuqinë e detyrueshme të vendimit (*shih vendim nr. 29, datë 21.12.2006*). Në çështjen në shqyrtim, vendimi nr.106, datë 12.2.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilit i referohet kërkuesi, nuk i plotëson kriteret e mësipërme, pasi nuk ka forcë detyruese dhe është bërë objekt ankimi në Gjykatën e Apelit. Në këto kushte, edhe pse çështja, për arsye të moskompetencës⁵, ka kaluar për shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila është një gjykatë e ndryshme nga ajo fillestare dhe pjesa më e madhe e veprave penale, objekt gjykimi, kanë qenë të njëjta në të dyja gjykimet në shkallë të parë, në rastin konkret kemi të bëjmë me hallkat e një procesi gjyqësor në vazhdimësi, që është zhvilluar në përputhje me dispozitat penale në fuqi. Për këto arsye, Gjykata çmon se parimi *ne bis in idem* nuk është shkelur dhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën veprë është i pambështetur.

b) Në lidhje me pretendimin se është deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

Kërkuesi pretendon se provat e paraqitura nga akuza janë marrë në mënyrë të paligjshme, në shkelje të nenit 32/2 të Kushtetutës dhe neneve 5/2, 128, 129, 151/4 dhe 370/2 të KPP-së dhe për rrjedhojë janë të pavlefshme. Më konkretisht, sipas kërkuesit, disa procesverbale janë të papërdorshme për arsye të mungesës së nënshkrimit nga të gjithë personat pjesëmarrës në këqyrje, ose për arsye se përmbajnë nënshkrime të personave që nuk kanë marrë pjesë në këqyrje. Gjithashtu kërkuesi pretendon se është shpallur fajtor mbi bazën e deklarimeve të nënshkruara nën efektin e “torturës” dhe që nuk përmbajnë nënshkrimin e mbrojtësit. Sipas jurisprudencës kushtetuese, tashmë të konsoliduar, marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë (*shih vendimet nr.23, datë 23.7.2009; nr.19, datë 18.9.2008; nr.7, datë 27.4.2005; nr.95, datë 27.7.2001 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim i rëndësishëm trajtohet edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, në drejtim të respektimit të së drejtës për t’u mbrojtur. Në çështjen Bykov kundër Rusisë, datë 10 mars 2009, § 90, GJEDNJ-ja ka theksuar se për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre. Nga shqyrtimi i materialeve të dosjes gjyqësore, në çështjen konkrete, Gjykata vëren se është lejuar marrja në cilësinë e provës vetëm të atyre deklaratave ku të pandehurve iu është bërë e qartë e drejta për të pasur mbrojtës gjatë pyetjeve dhe prej tyre është dhënë pëlqimi për t’u pyetur pa praninë e mbrojtësit. Këto deklarime janë vlerësuar në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre, në respektim të dispozitave procedurale penale.

⁴ Shih nenin 4, Protokollin VII i KEDNJ; nenin 14, § 7 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; nenin 50 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian

⁵ Në këtë kontekst duhet sqaruar gjithashtu se Gjykata e Krimeve të Rënda nuk ishte krijuar ende kur çështja është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, prandaj problemi i kompetencës ka dale në një fazë të mëvonshme, pikërisht pas përfundimit të gjykimit në shkallën e parë.



Bindja e gjykatës për fajësinë e kërkuesit është formuar jo vetëm në bazë të provave të kundërshtuara si të pavlefshme nga kërkuesi, por duke u mbështetur në një sërë provash të tjera të administruara gjatë gjykimit, si procesverbale të këqyrjes, fotografi, ekspertime tekniko-balistike, akt-ekspertime, dëshmitarë. Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente provuese të mjaftueshme që të evidentojë se dëshmitarët i janë nënshtruar torturës, në mënyrë që Gjykata të bëjë një vlerësim të ndryshëm nga ai që kanë bërë gjykatat e zakonshme lidhur me këtë aspekt. Në vlerësimin e Gjykatës kërkuesi i ka ngritur pretendimet në lidhje me mënyrën e marrjes së provave përpara gjykatave të zakonshme, çka nënkupton se atij i është dhënë mundësia për të vënë në dukje mangësitë e provave nga ana formale, si dhe për të kundërshtuar autenticitetin dhe ligjshmërinë e tyre. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit se provat në proces janë marrë në mënyrë të paligjshme është i pabazuar.

c) Në lidhje me pretendimin se është shkelur parimi i barazisë së armëve

Kërkuesi këtë pretendim e mbështet te mosadministrimi nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, i provave të kërkuara nga mbrojtja dhe mosarsyetimi i vendimeve për mospranimin e këtyre provave. Gjykata ka ritheksuar se, veçanërisht në procesin penal, parimi i barazisë së armëve përbën një nga elementet më thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Ky standard kushtetues nënkupton që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme, për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e venë në disavantazh me palën tjetër, në funksion të realizimit të një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes (*shih vendimet nr.23, datë 23.7.2009; ; nr.10, datë 2.4.2009; nr.19, datë 18.9.2008; nr.13, datë 21.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me mospranimin e provave të kërkuara nga mbrojtja, Gjykata e ka ripohuar tashmë qëndrimin e saj të konsoliduar se kërkesa për marrje provash jo domosdoshmërisht duhet të pranohet nga gjykata dhe se vlerësimi i tyre është kompetencë e gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 37, datë 19.9.2011; nr.106, datë 1.8.2001 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar në mënyrë të vazhdueshme se marrja dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave, interpretimi i ligjit material dhe procedural dhe aplikimi i tij në çështjet konkrete, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimin nr.14, datë 3.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe GJEDNJ-ja është shprehur se “neni 6 garanton të drejtën për një proces të rregullt, por nuk përcakton rregullat për pranimin e provave si të tilla, çështje e cila i përket kryesisht rregullimit sipas legjisllacionit të brendshëm” (*shih Schenk kundër Zvicrës, 12 korrik 1988, § 45*). Nga analiza e dosjes gjyqësore vërehet se në të gjitha shkallët e gjykimit mbrojtësit të kërkuesit i është dhënë mundësia për të dëgjuar dhe debatuar të gjitha provat e paraqitura nga akuza dhe vendimet e gjykatës për mospranimin e provave të kërkuara nga mbrojtja nuk paraqesin elementë të cenimit të standardit të *barazisë së armëve*. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar dhe duhet rrëzuar.

ç) Në lidhje me pretendimin për mosarsyetimin e vendimit gjyqësor

Kërkuesi pretendon se vendimet e gjykatave nuk janë arsyetuar, pasi nuk përmbajnë një analizë të provave të shqyrtuara. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*Shih vendimet nr.23, datë 23.7.2009; nr.7, datë*

9.3.2009 dhe nr.33, datë 8.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese). Në vlerësimin e Gjykatës, nuk rezulton që vendimet gjyqësore të jenë jologjike, të kenë kundërthënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojnë elementët e përmendur më sipër. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se vendimet e gjykatave nuk cenojnë kërkesat që lidhen me arsyetimin e vendimit gjyqësor në kuptimin kushtetues dhe pretendimi i kërkuarit në këtë aspekt është i pazuar.

d) Në lidhje me pretendimin se i është cenuar e drejta e prezumimit të pafajësisë

Për këtë pretendim kërkuar ka parashtruar dy argumente: së pari, gjykata, duke u mbështetur në prova të marra në mënyrë të paligjshme, ka prezumuar fajësinë e tij; dhe së dyti, zyrtarë të shtetit të kohës kanë bërë deklarata të ndryshme publike në lidhje me fajësinë e tij, pa mbaruar ende procesi gjyqësor. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilin është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimet nr.23, datë 23.7.2009, dhe nr.9, datë 28.4.2004 të Gjykatës Kushtetuese*). Prezumimi i pafajësisë është trajtuar gjerësisht edhe nga GJEDNJ-ja, e cila në çështjen *Allenet de Ribemont kundër Francës*, datë 10 shkurt 1995, §35, ka theksuar se “prezumimi i pafajësisë është një nga elementët e procesit të rregullt ligjor që parashikohet në nenin 6 par. 2. Ky parim konsiderohet i shkelur nëse një vendim gjyqësor, që i përket një individi të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është fajtor përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit. Edhe nëse nuk ka ndonjë konkluzion formal mjafton që të ketë një arsyetim i cili lë të kuptohet se gjykata e konsideron të akuzuarin fajtor” (*përkthim i Gjykatës*). Nga vlerësimi në tërësi i materialeve të paraqitura Gjykatës, nuk rezulton ndonjë e dhënë e cila të tregojë se anëtarët e gjykatave të zakonshme që kanë shqyrtuar çështjen, e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuar i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Bazuar në sa më sipër, Gjykata çmon se nuk është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë ndaj kërkuarit.

23. Si përfundim, për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuar, në kuptim të garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.00-2010-933 (731), datë 2.7.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, njëzëri.
 - Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm (votuan kundër: V. Tusha dhe A. Xhoxhaj).
 - Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar,) Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Pllloçi, Sokol Sadushi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza.



VENDIM
Nr.48, datë 8.11.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Xhezair Zaganjor	anëtar i “ “
Petrit Ploçi	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Admir Thanza	anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e “ “
Sokol Sadushi	anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 10.6.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 16 Akti, që i përket:

KËRKUES: Bashkia e Tiranës, përfaqësuar nga Natasha Kondi, Migena Vishka dhe Majlinda Dhuka, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj dhe Arjeta Çefa, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushtetit qendror (Kuvendi i Shqipërisë) dhe pushtetit vendor (Bashkia e Tiranës);

Shfuqizimi i vendimit nr.66, datë 21.10.2010 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar” si i papajtueshëm me Kushtetutën;

Pezullimi i zbatimit të vendimit nr.66, datë 21.10.2010 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 7, 13, 113, 118, 131/ç dhe 134/e të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 45, 54, 55 e 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Sadushi, subjektin kërkues që u shpreh për pranimin e kërkesës, subjektet e interesuara që u shprehën për rrëzimin e saj, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN
I

1. Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr.66, datë 21.10.2010 “Për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar”(vendimi nr.66), ka vendosur: “*Ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar në vendin ku ndodhet Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Pjetër Arbërori”*”(pika I). Sipas këtij vendimi, projekti i Kompleksit të ri Parlamentar realizohet me anë të konkursit ndërkombëtar (pika II) dhe vlerësohet nga një juri ndërkombëtare, e përbërë prej arkitektësh të shquar (pika III). Destinacioni i ndryshuar i sheshit, parashikuar në pikën 1 të vendimit nr.66, dhe procedura që do të ndiqet për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar përcaktohen me ligj të veçantë të Kuvendit (pika IV). Për ndjekjen dhe zbatimin e vendimit nr.66 krijohet një Komision Shtetëror, i përbërë nga: Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Ministri i Punëve Publike dhe Transporteve, Ministri i Financave, Kryetari

i Bashkisë së Tiranës, dy kryetarët e grupeve më të mëdha parlamentare në Kuvend dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Ky Komision përcakton studiot e njohura ndërkombëtare që u dërgohet ftesa të marrin pjesë, si dhe miraton Rregulloren e Organizimit të Konkursit Ndërkombëtar (pika V). Për realizimin e fazës së ndërtimit, Kuvendi përdor një fond të ndarë sipas zërave në aneksin 3 të vendimit nr.66 (pika VI). Pranë Kuvendit ngrihet Njësia Teknike e Ndhmës dhe Asistencës për realizimin e Kompleksit të ri Parlamentar (pika VII)

2. Bashkia e Tiranës (*subjekti kërkues*), nëpërmjet Kryetarit të saj, në cilësinë e organit ekzekutiv, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me pretendimin se ndërmjet qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror ka lindur një mosmarrëveshje në ushtrimin e kompetencave të tyre kushtetuese, si pasojë e miratimit të vendimit nr.66 në kundërshtim me parashikimet ligjore e kushtetuese. Subjekti kërkues ka identifikuar si shkak kryesor të mosmarrëveshjes, ushtrimin e kompetencave të organeve të qeverisjes vendore në fushën e planifikimit, menaxhimit urban dhe kontrollit mbi territorin, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë. Gjykata është investuar për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje kompetencash midis dy pushteteve, që pretendohet nga subjekti kërkues.

3. Subjekti kërkues, **Bashkia Tiranë**, ka parashtruar përpara Gjykatës se:

3.1 Vendimi nr.66 ka cenuar kompetencat e pushtetit vendor në fushën e planifikimit urban dhe menaxhimit të territorit, kompetenca këto të njohura si “funsione të veta” në bazë të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (neni 10, pika 3/I/g; neni 72, pika 5/I/c), ligjit nr.8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, i ndryshuar, (neni 14; neni 20, pika 2/e; neni 22/1 paragrafi 6 dhe 8; neni 48).

3.2 Vendimi nr.66 cenon parimet kushtetuese të decentralizmit dhe autonomisë vendore, të sanksionuara në nenin 13 të Kushtetutës dhe në Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore dhe vjen në kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, i parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës.

3.3 Vendimi nr.66 ka shkelur parimin e shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, për arsye se: Kompleksi i ri Parlamentar që do të ndërtohet nuk është në përputhje me studimet urbanistike të miratuara për zonën; miraton në mënyrë jo të drejtpërdrejtë shembjen e godinës ekzistuese e cila ndodhet në zonën e shpallur “Ansambël Monument Kulture”, për shembjen e së cilës mund të marrë vendim vetëm Këshilli i Rregullimit të Territorit (KRRT) i Bashkisë së Tiranës; përjashton KRRT-në e Bashkisë së Tiranës nga e drejta për të ushtruar funksionin e miratimit të platformave të konkurseve për studime urbanistike; parashikon se do të miratohet një ligj i veçantë për procedurat e ndërtimit, ligj i cili nuk mund të “përjashtojë” pushtetin vendor nga kryerja e misionit dhe funksioneve të tij, ndër të cilat përfshihet dhe planifikimi dhe menaxhimi i territorit; përcakton ngritjen e një strukture (Njësia Teknike e Ndhmës dhe Asistencës), e cila do të “dublojë” një strukturë ekzistuese, siç është këshilli teknik; nuk është nxjerrë në përputhje me kriteret kushtetuese dhe ligjore të parashikuara në nenin 118 të Kushtetutës.

4. Subjekti kërkues ka paraqitur paraprakisht kërkesën për pezullim të vendimit nr.66, duke argumentuar se: ka një dyshim serioz në lidhje me vlefshmërinë dhe kushtetutshmërinë e këtij vendimi; ekziston një urgjencë për pezullimin e zbatimit duke pasur parasysh se ky vendim ka filluar të zbatohet; duhet të parandalohen pasojat e pariparueshme të karakterit pasuror, financiar dhe ligjor që vijnë nga ky ekzekutim.

5. Subjekti i interesuar, **Kuvendi i Shqipërisë**, ka parashtruar me shkrim dhe në seancën plenare prapësimet e tij në këto drejtime kryesore:

5.1 Kërkesa e Bashkisë Tiranë është pa objekt, për arsye se nuk jemi në kushtet e një mosmarrëveshjeje kompetencash; Kuvendi i Shqipërisë, me anë të vendimit nr.66, ka shprehur vullnetin për fillimin e procedurave për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar. Vendimi është në kuadrin e idesë dhe jo të procedurave realizuese. Fjala “ndërtim” nuk është përdorur në kuptimin e drejtpërdrejtë praktik të saj, pasi Kuvendi, në pikën 1 të vendimit nr.66, nuk shprehet për prishjen e ndonjë godine, por vetëm prezanton objektivin dhe qëllimin e Kuvendit për të ngritur një kompleks të ri parlamentar.



5.2 Vendimi nr.66 është një vendim që rrjedh nga Rregullorja e Kuvendit dhe është i një natyre të veçantë, pasi disponon për një çështje konkrete, siç është ndërtimi i Kompleksit të ri Parlamentar, dhe si i tillë nuk ka si detyrim t'i referohet një ligji të posaçëm.

5.3 Pezullimi i vendimit nr. 66 nuk mund të kërkohet, sepse nuk jemi në kushtet e cenimit të interesave shtetërore, shoqërore ose individuale, sipas përcaktimit të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Për më tepër, nuk rezulton të ketë asnjë shembje godine, ndërtim apo fillim punimesh pranë Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës "Pjetër Arbunori".

5.4 Me urdhrin nr.610, datë 22.12.2010, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i ka hequr statusin si "monument kulture" Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës "Pjetër Arbunori".

5.5 Planifikimi urban dhe menaxhimi i territorit nuk janë kompetenca të përcaktuara nga norma kushtetuese, siç pretendon Bashkia e Tiranës.

5.6 Ndërtimi i Kompleksit të ri Parlamentar është një çështje e rëndësishme kombëtare.

5.7 Bashkia e Tiranës nuk mund të parashikojë apriori dhe në mënyrë hipotetike antikushtetutshmërinë e një projektligji, i cili në vetvete nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese.

6. Subjekti i interesuar, *Këshilli i Ministrave*, ka parashtruar me shkrim dhe në seancën plenare shpjegime në këto drejtime kryesore:

6.1 Kërkesa e Bashkisë së Tiranës është një kërkesë pa objekt dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës nuk legjitimohet as nga pikëpamja formale, as nga ajo procedurale, për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk ka tagër përfaqësimi.

6.2 Gjykata Kushtetuese vendos mbi mosmarrëveshjen e kompetencës në planin normativ kur kjo lind nga një konflikt midis dy ligjeve për çështje përkatësie kompetencash dhe jo kur jemi përpara një konflikti midis një ligji dhe një vendimi të Kuvendit.

6.3 Vendimi nr.66 artikulon vetëm vullnetin e Kuvendit për fillimin e procedurës së ndërtimit të Kompleksit të ri Parlamentar dhe nuk është akt tipik nënligjor.

II

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) mori paraprakisht në shqyrtim, përpara seancës plenare, kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr.66. Në kuptim të nenit 45 të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim, për arsye të mungesës së argumenteve bindëse për cenimin e interesave shtetërore, shoqërore ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të këtij vendimi.

III

A. Lidhur me pretendimin e moslegjitimitit të subjektit kërkues për t'ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese

7. Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, kanë pretenduar në parashtrimet e tyre se subjekti kërkues, Bashkia e Tiranës, nëpërmjet Kryetarit të saj, nuk legjitimohet të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke arsyetuar se Kryetari i Bashkisë së Tiranës nuk ka tagër përfaqësimi. Gjykata e çmon të arsyeshme të ndalet, fillimisht, në aspektin e legjitimitit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë për t'iu drejtuar Gjykatës me një kërkesë të kësaj natyre. Neni 54/3 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", parashikon specifikisht se për mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, të përcaktuara nga neni 131, shkronja "ç" i Kushtetutës, kërkesa ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti. Pavarësisht nga karakteri i shkakut që lind mosmarrëveshjen, Gjykata vendos, sipas nenit 56 të ligjit të

sipërpërmendur, se cili organ i pushtetit ka në kompetencë zgjidhjen e çështjes konkrete për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. Veç kësaj, kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ka të bëjë me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata shqyrton gjithashtu edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit. Nisur nga pretendimet e subjektit kërkues, të cilat përqendrohen tek krijimi i një mosmarrëveshjeje kompetencash midis pushtetit vendor dhe atij qendror, i vetmi instrument për zgjidhjen e këtij konflikti është shqyrtimi i çështjes nga Gjykata me qëllim që kjo të vlerësojë fillimisht nëse ka një konflikt kompetencash dhe më pas të përcaktojë organin kompetent për nxjerrjen e aktit normativ përkatës, si dhe të kontrollojë pajtueshmërinë ose jo të tij me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

8. Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese tashmë të konsoliduar, Gjykata ka vlerësuar se *“çdo organ pushteti legjitimohet të bëjë kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese kur ai pretendon se ndodhet para një konflikti kompetence”, duke vijuar se “Bashkia e Tiranës, nëpërmjet Kryetarit të saj, si organ ekzekutiv i qeverisjes vendore, si një ndër subjektet e parashikuara nga neni 134/1, shkronja “e” i Kushtetutës, dhe, për më tepër, si subjekt në konflikt⁶, legjitimohet në aspektin kushtetues për të ngritur çështje të kësaj natyre. Edhe në aspektin e legjitimitimit formal e procedural është Kryetari i Bashkisë, i cili mban edhe pozicionin e Kryetarit të KRRT-së, që sipas ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ushtron të gjitha kompetencat që ligji i ka njohur komunës ose bashkisë në fushën e planifikimit urban⁷ (vendimi nr.29, datë 21.12.2006, i Gjykatës Kushtetuese). Në mënyrë të qartë Gjykata ka shpjeguar se “është pikërisht Kryetari i Bashkisë dhe jo këshilli bashkiak, organi i qeverisjes vendore që justifikon në këtë rast interesin e tij për të vënë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja “e”, të Kushtetutës” (vendimi nr.22, datë 5.5.2010 i Gjykatës Kushtetuese).*

9. Në vijim të arsytimit të mësipërm, Gjykata vlerëson se subjekti kërkues, nëpërmjet Kryetarit të saj, legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për çështjen objekt shqyrtimi.

B. Lidhur me pretendimin e krijimit të mosmarrëveshjes së kompetencës midis pushtetit vendor dhe pushtetit qendror

10. Si shkak kryesor për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet këtyre pushteteve, subjekti kërkues ka identifikuar ushtrimin e kompetencave të organeve të qeverisjes vendore në fushën e planifikimit, menaxhimit urban dhe kontrollit mbi territorin, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, në bazë të vendimit nr.66, të miratuar nga ligjvënësi. Duke iu referuar raportit që ekziston midis organeve administrative dhe funksioneve të tyre, një mosmarrëveshje kompetencash sjell si pasojë një akt të cenueshëm. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se mosmarrëveshja e kompetencës mund të paraqitet si në formën e konfliktit *“normativ”*, kur kompetenca që përbën objektin e mosmarrëveshjes parashikohet në ligje, ashtu edhe në formën e konfliktit *“individual”*, kur institucionet në konflikt nxjerrin aktet përkatëse për zbatimin e një ligji konkret, akt i cili bëhet shkak për mosmarrëveshje. Mosmarrëveshjet e kompetencës mund të shkaktohen edhe kur një ligj u atribuon të njëjtën kompetencë dy a më shumë institucioneve, kur e njëjta kompetencë u atribuohet sipas ligjeve të ndryshme dy institucioneve, si dhe kur ligji parashikon kompetencën, por pa saktësuar organin që duhet ta ushtrojë. Zgjidhja e çështjeve të kësaj natyre nuk mund të bëhet me kontroll kushtetues *in abstracto*. Prandaj, fakti se cilit organ i takon një kompetencë e debatuar përcaktohet duke u nisur nga një çështje konkrete, kur organi e ka zbatuar ligjin konfliktual dhe ka nxjerrë, mbi këtë bazë, aktin individual të zbatimit. Në praktikë, një konflikt i tillë mund të lindë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, por që përmban një shprehje të qartë të vullnetit, me të cilën pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit (*shih vendimet nr.29, datë 21.12.2006; nr.26, datë 4.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka vërejtur se, përveçse në hipotezat e mësipërme, bazuar në doktrinën kushtetuese, *“konflikti mund të lindë edhe kur një organ nuk kërkon për vete*

⁶ Sipas nenit 54, pika 3 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

⁷ Ligji nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 10, pika 3/1, 32, 44 etj.



kompetencën për të përmbushur një akt të caktuar, por pretendon që sjellja mosvepruese e një organi tjetër ose një akt i tij kanë zvogëluar kompetencat e tij ose e kanë penguar në ushtrimin e tyre” (shih vendimin nr.22 të Gjykatës Kushtetuese, supra).

11. Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se vendimi nr.66, objekt shqyrtimi, është një akt individual, i cili është nxjerrë nga organi kompetent, Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Në bazë të nenit 106/1 të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi, si pushtet ligjvënës, përveç miratimit të ligjeve, nxjerr edhe vendime, rezoluta dhe deklarata. Vendimi nr.66 është shprehje e iniciativës së ligjvënësit për ndërtimin e një Kompleksi të Ri Parlamentar. Ndër të tjera, ky vendim, parashikon miratimin e një ligji të veçantë, për sa i përket procedurës që do të ndiqet për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar. Nisur nga teksti i vendimit nr.66, Gjykata çmon se nuk rezulton ndonjë shmangie e rolit dhe kompetencave të Bashkisë së Tiranës, në lidhje me procedurat përkatëse për kërkim lejesh, miratim të projektit të zbatimit, të shesheve dhe lejeve të ndërtimit, apo shqyrtim të kërkesave për prishje objektesh. Në asnjë pikë të vendimit nr.66, nuk parashikohet përjashtimi i Bashkisë së Tiranës nga ushtrimi i kompetencave të lartpërmendura, të cilat ligji nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe ligji nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar, ia kanë atribuuar. Në vijim të këtij arsytimi, Gjykata vlerëson se vendimi nr.66 nuk krijon efekte juridike në drejtim të uzurpimit të kompetencave të pushtetit vendor në fushën e planifikimit urban dhe menaxhimit të territorit. Për pasojë, Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 66, nuk ndërhyt në kompetencat e Bashkisë së Tiranës, dhe pretendimet e subjektit kërkues për cenim të nenit 7 dhe 13 të Kushtetutës, janë haptazi të bazuara.

12. Si përfundim, bazuar në vlerësimet e mësipërme, Gjykata arrin në konkluzionin se vendimi nr.66, datë 21.10.2010 “Për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar”, nuk ka shkaktuar konflikt kompetencash midis subjektit kërkues, Bashkia e Tiranës dhe Kuvendit të Shqipërisë.

PËR KËTË ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza.

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Petrit Pllloçi, Sokol Sadushi

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, për sa i takon rrëzimit të kërkesës së paraqitur nga Bashkia e Tiranës, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice. Në rastin konkret, mosmarrëveshja objekt shqyrtimi pretendohet se ka lindur për shkak se nxjerrja e vendimit nr. 66, datë 21.10.2010, të Kuvendit të Shqipërisë “Për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar” (vendimi nr. 66) i atribuon pushtetit qendror kompetenca që ligjet në fuqi ia njohin ekskluzivisht pushtetit vendor (Bashkisë Tiranë). Shumica, nëpërmjet arsytimit të saj, ka arritur në konkluzionin se vendimi nr. 66 nuk krijon efekte juridike të menjëhershme dhe si i tillë nuk ndërhyt në kompetencat e pushtetit vendor.

2. Pakica e konsideron të rëndësishme të ritheksojë parimet kushtetuese që rregullojnë funksionimin e qeverisjes vendore në raport me qeverisjen qendrore. Sipas jurisprudencës kushtetuese *“thelbi i nenit 13 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë janë parimi i decentralizimit të pushtetit dhe i autonomisë vendore. Në të vërtetë, ai që decentralizohet është ushtrimi i pushtetit në formë ndarjeje të kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore. Duke iu referuar rregullave të Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se orientimet kryesore që ajo përcjell tek shtetet anëtare, nënshkruese të saj për një kuptim të drejtë të parimeve të demokracisë e të decentralizimit të pushtetit, kërkojnë “ekzistencën e bashkësive vendore të pajisura me organe vendimore të formuara në mënyrë demokratike dhe që gëzojnë një autonomi të gjerë për sa u përket kompetencave, mënyrave të ushtrimit të këtyre të fundit dhe mjeteve të nevojshme për përmbushjen e misionit të tyre.”* (vendimi nr. 29, datë 21.12.2006, i Gjykatës Kushtetuese).

3. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) është shprehur se vetëqeverisja vendore paraqitet me një status kushtetues që konsiston, midis të tjerave, në ushtrimin nga organet e qeverisjes vendore të funksioneve brenda juridiksionit të tyre, pa ndërhyrjen e organeve të pushtetit qendror (neni 113 i Kushtetutës), në ekzistencën e mjeteve financiare dhe të mjeteve të tjera, me të cilat ajo disponon në mënyrë të pavarur (nenet 111, 113, shkronja “b”, “c”, “ç”, të Kushtetutës) ëshih vendimin nr. 29/2006 supra].

4. Në lidhje me kompetencat e organeve të qeverisjes vendore, Gjykata ka nënvizuar se ato duhet të jenë të tilla që një pjesë e mirë e çështjeve publike të rregullohen sipas parimit të subsidiaritetit. Rregullimi dhe menaxhimi i çështjeve të caktuara publike duhet të ushtrohet nga organe që qëndrojnë sa më afër qytetarëve dhe të shoqërohet edhe me mjete efektive për konkretizimin e tyre. Në realitet, shumë çështje kanë implikime si vendore ashtu edhe kombëtare dhe përgjegjësia mund të ndahet ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes por gjithsesi, kufizimi i veprimtarisë së autoriteteve vendore vetëm në çështje që nuk kanë implikime të gjera, mbart rrezikun për t’i shndërruar ato në autoritete me një rol të parëndësishëm.

5. Në jurisprudencën kushtetuese, për çështje që kanë pasur për objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore, qëndrimi tashmë i konsoliduar i Gjykatës është se *“planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës janë kompetenca të plota dhe ekskluzive të autoriteteve vendore dhe përfshihen në konceptin ligjor “funksionet e veta”, sipas të cilit, nëpërmjet lirisë dhe autoritetit për të marrë vendime, ato janë përgjegjëse për realizimin e tyre”* (shih vendimin nr. 29/2006).

6. Neni 131, shkronja “ç”, i Kushtetutës përfshin mosmarrëveshjet që lindin midis pushteteve si në rrafshin horizontal (ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor), ashtu edhe në rrafshin vertikal (pushtet qendror-qeverisje vendore). Një konflikt i tillë mund të lindë në praktikë si pasojë e nxjerrjes së një akti juridik, që përmban një shprehje të qartë të vullnetit, me të cilin pohohet e drejta e ushtrimit të pushtetit/kompetencave. Pavarësisht nga pretendimet për përkatësinë e pushtetit, një konflikt kompetencash mund të konkretizohet edhe në rast se ushtrimi abuziv i kompetencave nga njëri pushtetit pakëson ose pengon ushtrimin e kompetencave që Kushtetuta ia atribuon pushtetit tjetër.

7. Shumica në këtë çështje, pretendimin e Bashkisë së Tiranës se vendimi nr.66, datë 21.10.2010, i Kuvendit të Shqipërisë ka krijuar një konflikt kompetencash midis pushtetit qendror dhe atij vendor, e ka çmuar të pabazuar, me argumentin se vendimi nr. 66 nuk krijon efekte juridike, dhe për pasojë nuk cenon kompetencat e pushtetit vendor në fushën e planifikimit urban dhe menaxhimit të territorit.

8. Nuk jemi dakord me këtë qëndrim të shumicës për arsyet që do të argumentojmë në vijim.

9. Pakica konstaton se ndërmjet qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror ka lindur në fakt një mosmarrëveshje për ushtrimin e kompetencave të tyre në fushën e planifikimit, të menaxhimit urban, si dhe të kontrollit mbi territorin. Ndryshe nga sa ka vlerësuar shumica, çmojmë se situata



ligjore që ka krijuar vendimi nr.66 ka shkaktuar një situatë faktike konfliktuale, e cila është baza dhe shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore. Sipas këndvështrimit tonë, vendimi nr.66 i Kuvendit krijon efekte juridike të menjëhershme, duke u nisur nga disa pika të veçanta të tij.

10. Së pari, vendimi nr.66 përcakton qartësisht vendin ku planifikohet se do të ndërtohet Kompleksi i ri Parlamentar (pika I e vendimit), sipas planvendosjes që i bashkëlidhet vendimit. Ky përcaktim jo vetëm identifikon në mënyrë të qartë nga pikëpamja urbanistike vendndodhjen e Kompleksit të ri Parlamentar që do të ndërtohet, por përbën edhe një ndryshim të destinacionit të sheshit, duke pasur parasysh se Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Pjetër Arbërori”, e cila është godinë ekzistuese, ndodhet pikërisht në këtë vend. Për më tepër, në pikën IV të vendimit nr.66 pohohet haptazi se *destinacioni i ndryshuar* i sheshit është parashikuar në pikën I të këtij vendimi. Në bazë të nenit 20, pika 1, të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, *i ndryshuar*, “KRRT-ja në rreth dhe në bashki miraton dhe propozon ndryshime lidhur me sheshet e ndërtimit, me destinacionet e tyre së bashku me kushtet urbanistike të bazuara në studimet urbanistike të miratuara”. Sipas arsytimit të mësipërm, efekti juridik parësor që krijon vendimi nr.66 është ndryshimi i destinacionit të sheshit, çka në vlerësimin tonë përbën ndërhyrje në kompetencat e pushtetit vendor.

11. Së dyti, në pikën II të vendimit nr.66 parashikohet se konkursi ndërkombëtar për realizimin e projektit të Kompleksit të ri Parlamentar do të bëhet sipas detyrës së projektimit, e cila i është bashkëlidhur vendimit. Sipas nenit 3 dhe 20, pika 1, të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, *i ndryshuar*, “organet e pushtetit lokal janë administruese të territorit që ndodhet nën juridiksionin e tyre, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj” dhe “KRRT-ja në rreth dhe në bashki miraton dhe propozon ndryshime lidhur me: platformën për zhvillimin e konkurseve për studime urbanistike; *detyrën e projektimit* për çdo lloj studimi urbanistik për territorin në juridiksionin e saj”. Në vlerësimin e pakicës, fakti që detyra e projektimit është përcaktuar duke u bërë pjesë e vendimit nr.66 (aneksi 2), pa pjesëmarrjen e pushtetit vendor (siç rezultoi nga deklaratimet e palëve gjatë seancës plenare) dhe konkursi ndërkombëtar është zhvilluar, përbën një lloj përjashtimi të rolit që ka pushteti vendor në lidhje me planifikimin, menaxhimin urban dhe kontrollin mbi territorin.

12. Së treti, në pikën IV të vendimit nr.66 parashikohet se “destinacioni i ndryshuar i sheshit, parashikuar në pikën I të këtij vendimi, dhe procedura që do të ndiqet për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar përcaktohen me ligj të veçantë të Kuvendit”. Nisur nga ky formulim del qartë se procedura, mbi bazën e së cilës do të realizohet ndërtimi i Kompleksit të ri Parlamentar, do të përcaktohet me ligj të veçantë të Kuvendit. Procedura që ndiqet për ndërtimin e një godine të re është e mirëpërcaktuar, në të gjitha specifikat e saj, nga ligji nr.8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, *i ndryshuar*. Sipas këtij ligji, kompetencat në lidhje me ndryshimin e destinacionit të shesheve, miratimin e shesheve dhe lejeve të ndërtimit, miratimin e projektit të zbatimit, shqyrtimin e kërkesave për prishje godinash, dhënien e lejes së zhvillimit, i përkasin pushtetit vendor si funksione të veta në fushën e planifikimit, menaxhimit urban, dhe kontrollit mbi territorin. Në vijim të kësaj linje, arsytimi pakica vlerëson se Kuvendi, me vendimin nr.66, përcakton në perspektivë nxjerrjen e një ligji të veçantë ndërkohë që ekziston një kuadër ligjor i plotë, i cili përcakton hollësisht procedurën që ndiqet për ndryshimin e destinacionit të shesheve dhe ndërtimin e një objekti të ri.

13. Së katërti, Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Pjetër Arbërori” ndodhet në zonën e qendrës së qytetit, për të cilën është në fuqi Studimi Urbanistik i Qendrës së Qytetit i miratuar nga KRRTSH-ja⁸. Sipas nenit 4 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, *i ndryshuar*, “të gjitha ndërtimet në territorin e Republikës së Shqipërisë bëhen në bazë të studimeve urbanistike

⁸ Vendimi nr.1, datë 27.4.2004 “Për miratimin e Studimit Urbanistik të Qendrës së Qytetit të Tiranës” i KRRTSH-së

rajonale dhe mjedisore, të masterplaneve, të planeve rregulluese të përgjithshme, të studimeve urbanistike pjesore në fazën e projektidesë, të projektit teknik dhe projektit të zbatimit”. Kështu, sipas kësaj dispozite, studimet urbanistike janë pjesë e planifikimit urban, i cili është një nga funksionet e veta të pushtetit vendor. Në vlerësimin e pakicës, vendimi nr.66, duke parashikuar ndërtimin e një objekti të ri në vendin ku, sipas Studimit Urbanistik të Qendrës së Qytetit, duhet të jetë godina ekzistuese, cenon kompetencat e pushtetit vendor në fushën e planifikimit urban. Vetëm një ndryshim i Studimit Urbanistik të Qendrës së Qytetit do të mund të përcaktonte edhe ndryshimin e destinacionit të sheshit.

14. Së pesti, pakica nuk mund të anashkalojë edhe elementët që lidhen me faturën financiare të prishjes së Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës “Pjetër Arbërori”. Është e kuptueshme se kostoja financiare për prishjen e një godine të tillë do të ishte e konsiderueshme dhe nuk mund të mos pranohet se kjo do t’i shkaktojte buxhetit të shtetit një dëm financiar jo të papërfillshëm. Pakica, në funksion të përqasjes me realitetin, nuk mund të mbajë një qëndrim indiferent në lidhje me pasojat financiare që prishja e kësaj godine do të sillte.

15. Së fundi, pakica sjell në vëmendje se me vendimin nr.180, datë 13.4.2000 të Këshillit të Ministrave, aksi kryesor i qendrës historike të qytetit të Tiranës është shpallur Ansambël - Monument Kulture. Urdhri nr.610, datë 22.12.2010 i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me anë të të cilit është vendosur ‘heqja e statusit monument kulture të objektit Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Pjetër Arbërori”, ka dalë pasi është miratuar vendimi nr.66 i Kuvendit dhe është bazuar, inter alia, pikërisht në këtë vendimi. Si rrjedhojë, pakica konstaton se në momentin e miratimit të vendimit nr.66, objekti në fjalë ka gëzuar statusin e monumentit të kulturës.

16. Nisur nga çka më sipër, pakica çmon se vendimi nr.66 prodhon efekte juridike të menjëhershme, pasi ka përcaktuar ndryshimin e destinacionit të sheshit dhe planvendosjen, detyrën e projektimit, si dhe fondin përkatës për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar. Duke pasur parasysh se konkursi ndërkombëtar është zhvilluar dhe në bazë të vendimit nr.66 është shpallur projekti fitues, pakica vlerëson se për të garantuar një mirëfunksionim të institucioneve qendrore dhe vendore dhe në zbatim të parimit të decentralizimit dhe autonomisë vendore, bashkëpunimi midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore është i një rëndësie të veçantë. Gjatë seancës plenare rezultoi se, përpara daljes së vendimit nr.66, nuk ka pasur asnjë komunikim zyrtar midis institucioneve qendrore dhe vendore për sa i përket planvendosjes, detyrës së projektimit, apo ftesës për konkurs ndërkombëtar, aspekte të cilat lidhen me fushën e planifikimit, menaxhimin urban, dhe kontrollin mbi territorin. Bazuar në çka më sipër, pakica konstaton se për nxjerrjen e vendimit nr.66 nuk është konkretizuar paraprakisht asnjë formë bashkëpunimi midis institucioneve të nivelit qendror dhe atij vendor. Fryma e bashkëpunimit midis institucioneve të nivelit qendror dhe vendor është e domosdoshme, sidomos kur bëhet fjalë për ndërtimin e objekteve të tilla të rëndësishme në planin kombëtar.

17. Gjyqtarët në pakicë çmojnë të përmendin, në këtë kontekst, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Italisë, në çështje të ngjashme me çështjen në shqyrtim, e cila vlerëson se raportet midis shtetit dhe qeverisë vendore, sidomos për sa i përket sferave që janë në kufijtë e kompetencave institucionale reciproke, duhet të karakterizohen nga principi i bashkëpunimit të drejtë, transparencës, paanshmërisë dhe mirëkuptimit (*shih vendimin nr.7/2010 të Gjykatës Kushtetuese Italiane*).

18. Duke pasur parasysh çka më sipër, gjykojmë se vendimi nr.66 i Kuvendit ka krijuar efekte juridike të tilla, të cilat kanë shkaktoar një ndërhyrje në kompetencat e pushtetit vendor në fushën e planifikimit, menaxhimin urban dhe të kontrollit të territorit. Si konkluzion, pakica është e mendimit se, në çështjen objekt shqyrtimi, është krijuar një mosmarrëveshje kompetencash midis pushtetit qendror dhe atij vendor.

Anëtarë: Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Petrit Plloçi.



Ndreqje gabimi

Në Fletoren Zyrtare nr.149, datë 10.11.2011, në faqen 6871:

është:

Pagesa

Pagesa për shërbimet e dhëna nga kompania e kualifikuar, e caktuar nga Ministria Federale e Brendshme e Austrisë do të jetë:

- €350 000 - për mbështetjen IT;
- € 150 000 - për mirëmbajtje *software* në vit duke përfshirë shpenzimet e udhëtimeve, përjashtuar TVSH-në në Shqipëri.

bëhet:

Pagesa

Pagesa për shërbimet e dhëna nga kompania e kualifikuar, e caktuar nga Ministria Federale e Brendshme e Austrisë do të jetë:

- €350 000 - për mbështetjen IT;
- €150 000 - për mirëmbajtje *software* në vit duke përfshirë shpenzimet e udhëtimeve, përjashtuar TVSH-në në Shqipëri.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 21.11.2011
Doli nga shtypi më 23.11.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja Mediaprint
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë